

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5628  
E mërkurë, 14 nëntor 2018  
çmimi 0.40 €

## Gruevski kërkon azil politik në Hungari

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", DHURATA HOXHA | FAQE 4-5

# BE-ja TA MBAJË FJALËN PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, i ka quajtur joracionale dilemat e disa vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ajo ka thënë se dilemat e tilla e cenojnë rëndë kredibilitetin e BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha ka thënë se është mjaft e çuditshme që Kosova po përballlet me dilema dhe pasiguri sa i përket liberalizimit të vizave, edhe pse i ka plotësuar të gjitha kriteret. Megjithatë, ajo shpreson se BE-ja do t'i përmbahet premtimit për vizat. Hoxha ka deklaruar se është thelbësore që vendimmarrja për vizat të bëhet në fillim të dhjetorit. Ajo ka bërë me dije se dështimi eventual i BE-së për liberalizimin e vizave pas përmbushjes së kriterëve do ta vinte në pikëpyetje besimin e Kosovës karshi BE-së



## AKTUALE

### ARRITJA DHE QËNDRUESH-MËRIA E PAQES

F. 12

PhD Salihe SALIHU



### REKTORI DEMA FTON STUDENTËT TË BËHEN PJESË E TRANSFORMIMIT TË UP-së

F. 8

### KURTI: PA ARSIM CILËSOR NUK KA ZHVILLIM EKONOMIK DHE MIRËQENIE

F. 8

## EKONOMI

### MINISTRIA E MJEDISIT PARALAJMËRON MASA PËR NDALIMIN E SHITJES SË THËNGJILLIT

F. 9

### MTI-ja KËRKON NGA PRINDËRIT QË T'I LARGOJNË NGA FËMIJËT LODRAT E RREZIKSHME

F. 9

## KULTURË

### KONGRESI I MANASTIRIT, VEPËR ELITARE E HISTORISË KOMBËTARE

F. 13



Hasan MUJAJ

## SPORT

### ZOGAJ: TITULLIN E GJERMANISË, PASTAJ TË BOTËS

F. 16



QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR MBLEDHJEN E RADHËS | FAQE 3

# Haradinaj: Zgjedhjet nuk i kemi në agjendë



Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, nuk beson se shkuarja e Listës Serbe në opozitë mund ta rrezojë Qeverinë. Ai ka bërë me dije të martën se tani në agjendë nuk janë zgjedhjet e reja. Sipas Haradinajt, Kosova tani e ka fokusin tek anëtarësimi në Interpol dhe te procesi i liberalizimit të vizave | FAQE 6-7

## Policia sekuestron 131 vetura të paregjistruara në Kosovë

FAQE 10



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Meta, pjesë e konferencës "Mesdheu i së ardhmes"

TIRANË, 13 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, mori pjesë në Konferencën "Mesdheu i së ardhmes", që u mbajt në Marsej të Francës. Në fjalën e tij para pjesëmarrësve të kësaj konference ndërkombëtare, presidenti Meta tha se ne jemi ende shumë larg për sa i takon potencialit tonë të mundshëm në industrinë detare dhe të turizmit. "Sektorë të tjerë potencialë përfshijnë bujqësinë dhe TIK (Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit), të cilat kanë filluar të lulëzojnë tashmë në

vendin tim. Financimi i BE-së për sipërmarrjet fillestare në këto fusha ka qenë i konsiderueshëm edhe falë aftësisë së këtyre të rinjve që kanë mësuar të flasin me gjuhën e Bashkimit Evropian", tha presidenti. "I paraqita Renaudit dëshirën time për të krijuar një bashkëpunim të strukturuar me Rajonin PACA, një nga rajonet më të bukura dhe më të begata të Francës dhe të Mesdheut. Duke qenë një motor i fuqishëm ekonomik, që renditet në vendin e tretë më të pasur në

Francë dhe në të 19-in në nivel evropian, PACA është një shembull i gjallë i potencialit të madh të Mesdheut", tha Meta. Presidenti i Rajonit PACA, Renaud Muselier, duke iu drejtuar presidentit të Republikës së Shqipërisë, theksoi: "Prania juaj mes nesh është një nder i madh. Ky akt i dytë mbahet nën përkuqjesjen tuaj". "Ju jeni kryetari i një shteti të rëndësishëm në pellgun e Mesdheut, i një kombi krenar dhe trashëgimtar i një historie kaq të pasur", tha Muselier.



# Gruevski kërkon azil politik në Hungari

Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, ka thënë se në ditët e fundit kam marrë një numër të madh kërcënimesh për jetën time dhe tani jam në Budapest ku kërkoja azil politik nga autoritetet hungareze. Ai ka shtuar se do t'i qëndrojë besnik kauzës së Maqedonisë dhe asnjëherë nuk do të heqë dorë



SHKUP, 13 NËNTOR - Ish-kryeministri i Maqedonisë, Nikolla Gruevski, bëri me dije se ka kërkuar azil politik në Hungari. Nëpërmjet një postimi në "Facebook" ai tha se në "ditët e fundit kam marrë një numër të madh kërcënimesh për jetën time. Tani jam në Budapest dhe kërkoja azil politik nga autoritetet hungareze".

Gruevski ka shtuar se "do t'i qëndroj besnik kauzës së Maqedonisë. Asnjëherë nuk do të heq dorë". Institucionet ende nuk kanë informata zyrtare nëse Gruevski ndodhet ose jo jashtë vendit. "Ende nuk e dimë nëse bëhet fjalë për arratisje ose jo. T'ua lëmë shërbimeve që ta zgjid-

hin rastin. Së pari duhet të vërtetojmë nëse Nikolla Gruevski ndodhet jashtë shtetit", ka deklaruar kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev.

Ndërkaq Qeveria e Hungarisë, në një përgjigje të shkurtër për "Radion Evropa e Lirë", nuk ka mohuar e as pohuar se Gruevski ka aplikuar për azil. "Nuk mund ta konfirmojmë ose mohojmë. Ne nuk komentojmë lidhur me aplikimet individuale të cilat ende janë në procesim", thuhet në përgjigjen e Qeverisë hungareze. Edhe nga partia e Gruevskit, VMRO-DPMNE-ja, thonë se nuk kanë informacione mbi vendndodhjen e ish-kryetarit të saj. Më herët, gjatë ditës, edhe Ministria e

Punëve të Brendshme e Maqedonisë tha se ende nuk kanë informacione mbi vendndodhjen e ish-kryeministrit Nikolla Gruevski për kapjen e të cilit të hënën policia ka lëshuar edhe fletarrestim me kërkesë të Gjykatës Penale të Shkupit.

Gruevski kërkohet që të dërgohet në burg për ta vuajtur dënimin prej dy vjetësh për shpërdorim të detyrës për blerjen e një makine luksoze qeveritare. Ministri i

Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, për gjendjen e krijuar ka fajësuar organet gjyqësore të cilat, sipas tij, nuk kishin caktuar masën e paraburgimit edhe për faktin se Gruevski po gjykohej edhe për vepra të tjera edhe më të rënda. "Imagjinoni, jepet paraburgim për vjedhje të rënda, ndërsa për vepra të rënda penale nuk ka paraburgim. Policia punon me urdhër të gjykatës. Ekzistojnë masa të sigurisë dhe

ato zbatohen në bazë të vendimeve të organeve gjyqësore", tha Spasovski. Ai tha se policia po mbledh informacione dhe po analizon të gjitha aspektet, por se detajet nuk mund të zbulohen pasi mund ta dëmtojnë gjithë procesin.

Policia të hënën në mbrëmje ka bastisur banesën e Nikolla Gruevskit, por nuk e ka gjetur aty, ndërsa ka tentuar të hyjë edhe në selinë e VMRO-DPMNE-së, së cilës edhe i takon. Nga opozita tentimin e policisë për bastisje e kanë vlerësuar presion politik, ndërsa u kanë bërë thirrje zyrtarëve policorë që në rast se dyshojnë se Gruevski fshihet brenda selisë së partisë, të futen bashkë brenda dhe të kontrollojnë.

Ish-kryeministri Nikolla Gruevski gjykohej edhe në disa procese të tjera gjyqësore për shpërdorime të tjera të detyrës zyrtare, për mashtrime zgjedhore, dhunë të porositur ndaj ish-drejtesve të opozitës në një komunë të Shkupit e për keqpërdorime të tjera financiare.

## Komiteti i NATO-s, miratohet programi për reformat në Maqedoni



SHKUP, 13 NËNTOR - Ministria e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska, pret që në fillim të vitit të ardhshëm Maqedonia të ulet përfundimisht në tryezën e Aleancës së Atlantikut të Veriut, ndonëse pa të drejtë vote.

Numri "një" i mbrojtjes pret që procesi i anëtarësimit në NATO të zhvillohet pa pengesa paralelisht edhe me ndryshimet kushtetuese. Sheqerinska bëri të ditur se më 6 dhjetor vendi do ta prezantojë programin me reformat e mbetura që Brukseli i kishte parashtruar në takimin e fundit të dy delegacioneve.

Sundimi i të drejtës, të drejtat e njeriut, lufta kundër krimit dhe korrupsionit, janë çështjet kryesore në këtë listë. "Funksionimi i të shtetit të së drejtës, funksionimi i sistemit ku edhe gjyqësori edhe prokuroria do të punojnë pa presione, do të punojnë të pavarura dhe në mënyrë profesionale. Pjesën më të madhe të këtyre ligjeve i paralajmëruam në planin tonë për anëtarësim në BE, bëhet fjalë për ndryshime më Kodin penal, Procedurën penale, prokurorinë publike, Këshillin penal, pakoja e reformave në gjyqësor është e domosdoshme

për NATO dhe BE", theksoi Radmilla Sheqerinska, ministre e Mbrojtjes.

Nëse vendi përmbush të gjitha obligimet në kohë pritet që ministri i Jashtëm Nikolla Dimitrov përmes një letre ta njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s se vendi është i gatshëm t'i respektojë obligimet që dalin nga Marrëveshja e Uashingtonit. Sheqerinska tha se pret që në shkurt Aleanca ta përgatisë protokollin për anëtarësim, ndërsa më pas të vijojë procesi i ratifikimit nga shtetet anëtare të NATO-s.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Haradinaj: Zgjedhjet nuk i kemi në agjendë

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, nuk beson se shkuarja e Listës Serbe në opozitë mund ta rrëzojë Qeverinë. Ai ka bërë me dije të martën se tani në agjendë nuk janë zgjedhjet e reja. Sipas Haradinajt, Kosova tani e ka fokusin tek anëtarësimi në Interpol dhe te procesi i liberalizimit të vizave

**EPOKA  
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, nuk shqetësohet për mundësinë e rrëzimit të Qeverisë dhe shkuarjes në zgjedhje të reja. Pas mbledhjes së Qeverisë, në një konferencë për medie, Haradinaj ka thënë se Kosova tani ka në agjendë disa tema më të rëndësishme sesa zgjedhjet. "Këto ditë nuk e kemi ndonjë agjendë për mundësinë e shkuarjes në zgjedhje. Për këtë temë nuk po bisedojmë. Ne kemi fokusimin tek Interpoli dhe liberalizimi i vizave, sepse kemi bukur shumë punë. Pra, kemi edhe disa tema të tjera dhe nuk i kemi zgjedhjet në tavolinë apo mundësinë e rënies së Qeverisë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Qeveria nuk mund të bjerë për shkak të një kërkesë të Listës Serbe. Sipas tij, Kosova ka probleme me Serbinë dhe jo me Listën Serbe. "Kuptohet, një debat i tillë ekziston, mirëpo ne nuk e kemi tani këtë temë. E kam përsëritur edhe më herët se Qeveria mund të bjerë, sepse në demokraci bien qeveritë, por nuk e shoh Qeverinë që bie për shkak se ka marrë një vendim të caktuar dhe është hidhëruar Lista Serbe", është shprehur Haradinaj. Ai ka folur edhe për fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi, duke përsëritur edhe një herë se nuk do të ndodhë asnjë korrigjim i kufirit në mes të këtyre dy shteteve.

Shefi i ekzekutivit ka bërë me dije se tani mund të shtohet presioni

ndaj Kosovës që në këtë fazë të dialogut të ndodh një Asociacion i Komunave me Shumicë Serbe me kompetenca shtesë. "Është krejt e arsyeshme që kjo mund të shfrytëzohet, pastaj edhe si formë e presionit, pra me territore dhe me kufij që pastaj ne për t'u kënaqur me një 'Zajednice' bukur të madhe. Kur kalon vala e kësaj ideje me kufij dhe me territore, atëherë do të jetë me pushtet të brendshëm. Kushtetuta, ashtu siç na obligon për territore, na obligon që të mos lejojmë një pushtet të tretë. Mirëpo lejon që të krijohet një asociacion kushtetues sikurse e kemi një. Pra, është e vdekur ajo ide (ndryshimi i kufijve). Disa herë e kam thënë, tani janë rrethana të tjera", ka thënë Haradinaj.

Kryeministri ka treguar se nuk ka biseduar me presidentin rreth takimeve të këtij të fundit në Paris, duke shtuar se nuk ka pasur diçka të re që është dashur ta bisedojë me kreun e shtetit. "Nuk shoh ndonjë mungesë të shkëmbimit të informatave. Kam pasur bisedë me zëvendëskryeministrin Pacolli pasi është kthyer prej Parisit. Jam takuar edhe me z. Veseli dhe me z. Limaj. Ato që i kam pasur me interes i di", është shprehur Haradinaj.

## Qeveria hap rrugën për zgjidhjen e statusit të zjarrfikësve

Qeveria e Kosovës ka miratuar konceptdokumentin për financat



e pushtetit lokal, i cili i hap rrugë ligjit të ri që do ta bartë buxhetin e tyre në nivel qendror. Deri më tani zjarrfikësit janë menaxhuar nga niveli qendror, por janë paguar nga buxheti lokal. Sipas projektligjit të ri, që do të pasojë nga ky konceptdokument, do të zgjidhet njëherë e mirë statusi i zjarrfikësve dhe do të hapet rrugë për vende të reja të punës, kushte më të mira pune dhe pagë më të mirë.

Në mbledhjen e së martës, Qeveria ka shqyrtuar raportin për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane 2016-2018 si dhe ka shqyrtuar listën e prioriteteve të Agjendës për Reforma Evropiane - ERA II për vitin 2019. Kabineti ka miratuar edhe dy projektligje:

Projektligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për kredi ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bak Austria AG për projektin e sistemit për largimin e ujërave të zeza në Komunën e Podujevës.

Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe kërkesa e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur për caktimin e shumës financiare për familjet e personave të zhdukur me rastin e organizimit të ceremonisë për rivarrimin e mbetjeve mortore të personave të zhdukur që identifikohen. Vlera e mbështetjes është 400 (katërqind) euro.

Qeveria ka miratuar edhe

vendimin për aprovimin kërkesës së Zyrës së Presidentit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 100 000 euro për pagesën e konsulencës për kompaninë amerikane Ballard Partners. Edhe kërkesa e Komunitetit të Mitrovicës për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 200 mijë eurosh për pagesën e obligimeve për furnizim me medikamente mjekësore dhe material shpenzues në institucionet shëndetësore të kësaj komune ka marrë miratimin e Qeverisë. Po ashtu, miratimin e kabinetit e ka marrë edhe vendimi për themelimin e Bordit Këshillues për Agjencinë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë.



## Fazli Hoxha: Zjarrfikësit duhet të kenë paga të merituar

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Anëtari i Kryesisë së Nismës Socialdemokrate, Fazli Hoxha, ka thënë se zjarrfikësit meritojnë paga dhe kushte më të mira. Hoxha në një postim në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se është koha e fundit që të mendohet për këtë kategori. "Në mbledhjen e Qeverisë së

Kosovës të martën u tha se në vitin 2019 zjarrfikësit do ta kenë statusin e merituar. Institucionet e vendit kërkesat e zjarrfikësve do të duhej t'i kenë më prioritet, sepse kjo kategori punëtorësh ka mbetur e lënë pas dore për vite të tëra. Zjarrfikësit duhet të kenë paga të merituar dhe kushte më të mira për

punën që bëjnë. Zjarrfikësit disa herë kanë paralajmëruar protesta për mosrealizimin e kërkesave të tyre. Pra, është koha e fundit që të mendohet për këtë kategori. Zjarrfikësit janë një prej kategorive më të rëndësishme në gjithë botën", ka shkruar Hoxha në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Dhurata Hoxha

# BE-ja ta mbajë fjalën për

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, i ka quajtur joracionale dilemat e disa vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës. Ajo ka thënë se dilemat e tilla e cenojnë rëndë kredibilitetin e BE-së. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Hoxha ka thënë se është mjaft e çuditshme që Kosova po përballet me dilema dhe pasiguri sa i përket liberalizimit të vizave, edhe pse i ka plotësuar të gjitha kriteret. Megjithatë, ajo shpreson se BE-ja do t'i përmbahet premtimit për vizat. Hoxha ka deklaruar se është thelbësore që vendim-marrja për vizat të bëhet në fillim të dhjetorit. Ajo ka bërë me dije se dështimi eventual i BE-së për liberalizimin e vizave pas përm-bushjes së kriterëve do të vinte në pikëpyetje besimin e Kosovës karshi BE-së

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

PRISHTINE, 13 NËNTOR - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka thënë të martën se është thelbësore që vendim-marrja për liberalizimin e vizave për Kosovën të bëhet në fillim të dhjetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka deklaruar se është e çuditshme që Kosova po përballet me dilema dhe pasiguri sa i përket liberalizimit, edhe pse i ka plotësuar të gjitha kriteret e këtij procesi. "Disa shtete kanë shfaqur dilema të cilat janë absolutisht joracionale dhe, si të tilla, cenojnë rëndë kredibilitetin e BE-së. Na është thënë se ky është një proces teknik, se plotësojini kriteret dhe do ta keni liberalizimin e vizave. Ne i kemi plotësuar kriteret dhe tani po përballemi me dilema dhe pasiguri e cila është mjaft e çuditshme. Kolumbisë i është dhënë liberalizimi i vizave, kurse për Kosovën kemi hezitime nga disa shtete, që mund të interpretohet edhe si frikë nga kosovarët", është shprehur Hoxha. Megjithatë, ajo shpreson se BE-ja do t'i përmbahet premtimit për vizat. Hoxha ka bërë me dije se dështimi eventual i BE-së për liberalizimin e vizave pas përm-bushjes së kriterëve do ta vinte në pikëpyetje besimin e Kosovës karshi BE-së. Madje ajo ka hedhur dyshime se nëse BE-ja nuk e mban fjalën për vizat si mund të jetë garantuese e marrëveshjes Kosovë - Serbi. "E thashë edhe më herët se dështimi eventual i BE-së që t'u përmbahet rregullave të veta e që janë rezultatet pas përm-



bushjes së kriterëve, pra liberalizimi i vizave për qytetarët tanë pas përm-bushjes së kriterëve do ta vinte në pikëpyetje të madhe besimin

tonë karshi BE-së dhe institucioneve të saj. Si mund të jetë garantuese e marrëveshjes me Serbinë një BE që nuk e mban fjalën dhe nuk i përfill procedu-

rat e veta", ka deklaruar Hoxha. Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, në këtë intervistë ka folur edhe për zbatimin e Agjendës për Reforma

Evropiane, me ç'rast ka thënë se nga 22 prioritetet deri më tani janë realizuar vetëm 8. Por, sipas saj, deri në fund të vitit pritet të realizohen prioritetet e

# r liberalizimin e vizave

masave që dalin nga MSA-ja. Megjithatë, ajo ka shprehur optimizëm se deri në fund të tremujorit të katërt do të ketë nivel më të lartë të realizimit të MSA-së.

**"Epoka e re":** Znj. Hoxha, javën e kaluar është mbajtur takimi ministror për integrimin evropian në të cilin është diskutuar për përmbushjen e obligimeve të agjendës evropiane për reforma. Mund të na tregoni se deri në ç'masë keni arritur ju si ministri, por edhe ministrinë e tjera, që t'i përmbushni obligimet që dalin nga ERA 1?

**Hoxha:** Ne kemi mundur të bëjmë më shumë, nga 22 prioritetet aktuale sipas shtyllave, tetë prioritetet janë zbatuar plotësisht (31.82 për qind) ndërsa tjerat presim që deri në fund të vitit të realizohen. Institucionet kanë punuar mjaft në këtë drejtim por puna do të vazhdojë me lansimin e ERA 2 ku duhet të jemi më të përkushtuar dhe të angazhohemi më shumë.

**"Epoka e re":** As Marrëveshja për Stabilizim Asocim (MSA) nuk është duke u zbatuar në nivelin e duhur. Çfarë jeni duke bërë në këtë drejtim në mënyrë që të rritet përqindja e zbatimit të MSA-së?

**Hoxha:** Në komitetin e MSA-së ne kemi raportin e tremujorit të dytë, i treti është në përgatitje, deri në fund të tremujorit të katërt, besoj në nivel të lartë të realizimit të masave të planifikuara të MSA-së. Ne kemi shtuar dukshëm zbatimin e prioritetëve dhe masave që dalin nga MSA-ja. Programi përmban 532 masa: 144 masa legjislative (27.06 për qind) dhe 388 masa zbatuese (72.94 për qind). Ministria e Integritimit është angazhuar dhe vazhdon të angazhohet maksimalisht që ta koordinojë procesin e implementimit dhe t'i ndihmojë sa më shumë institucionet zbatuese sepse gjithçka varet nga këto të fundit, domethënë janë ministrinë e linjës dhe institucionet përkatëse të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

**"Epoka e re":** Këto ditë janë shtuar zërat se Kosova rrezikon ta marrë liberalizimin e vizave, madje edhe kancelari austriak gjatë vizitës në Prishtinë ka bërë me dije se disa vende të BE-së janë skeptike për këtë proces. Çfarë është duke bërë Ministria e Integritimit Evropian në veçanti, por edhe Qeveria në

përgjithësi, për t'i larguar hamendjet e këtyre vendeve anëtare të BE-së?

**Hoxha:** Neve na është dhënë një udhërrëfyes me 95 kritere dhe ne i kemi plotësuar të gjitha kriteret. Ato i ka konfirmuar Komisioni Evropian me raportin përkatës. Disa shtete kanë shfaqur dilema të cilat janë absolutisht joracionale dhe cenojnë rëndë kredibilitetin e BE-së. Na është thënë se ky është një proces teknik, se plotësojini kriteret dhe do ta keni liberalizimin e vizave. Ne i kemi plotësuar kriteret dhe tani po përballemi me dilema dhe pasiguri e cila është mjaft e çuditshme. Kolumbisë i është dhënë liberalizimi i vizave, kurse për Kosovën kemi hezitime nga disa shtete, që mund të interpretohet edhe si frikë nga kosovarët. Shpresoj se institucionet e BE-së të reflektojnë dhe t'u përmbahen rregullave që kanë vënë vetë, në të kundërtën do ta dëmtonte rëndë besimin tonë në BE-në dhe institucionet e saj.

**"Epoka e re":** Ju në vazhdimësi keni deklaruar se zyrtarët e BE-së ju kanë premtuar se brenda vitit do t'i hiqen vizat Kosovës. Nga kush e keni marrë këtë garanci?

**Hoxha:** Jo një herë, por disa herë, të gjithë bartësit e përgjegjësive në Parlamentin Evropian, Komisionin Evropian dhe Bashkimin Evropian, komisionarët dhe personalitetet e shquara në BE, kanë vlerësuar të arriturat tona. Është vlerësuar secili kusht nga udhërrëfyesi, nga 95 sa i kishim ne, shumë më shumë se çdo shtet që ka liberalizimin, një për një i kemi realizuar. Premtimet e tyre kanë pasur të bëjnë me përmbushjen e detyrave tona e më pastaj fillon finalizimi. Po ashtu, kjo edhe ka ngjarë. Kemi edhe deklarata publike të këtyre zyrtarëve të cilët na kanë thënë se në momentin që plotësohet kriteri i fundit (demarkacioni me Malin e Zi) do të vijë liberalizimi. Këto deklarata janë të qasshme meqë janë publike.

**"Epoka e re":** Qeveria vazhdon të jetë optimiste se liberalizimi i vizave do të ndodhë brenda këtij viti?

**Hoxha:** Vendimarrja është në fillim të dhjetorit, procedurat për liberalizim, krahasuar me vendet që tashmë e kanë arritur, finalizimi i lëvizjes së lirë ka ngjarë brenda dy deri tri

jave. Ne nuk kemi devijuar asnjëherë informimin e drejtë të gjendjes sonë, kemi reflektuar konform punës sonë, konform konsensusit tonë nacional për rrugën tonë, konform rekomandimeve dhe premtimeve të vendimarrësve të BE-së. Pra, vendimarrja është thelbësore, të bëhet në fillim të dhjetorit, të tjerat janë procedura të implementimit.

**"Epoka e re":** Në rast se dështon liberalizimi i vizave, Kosova a do ta rishqyrtojë raportin e vet me Bashkimin Evropian si dhe

vazhdimin e dialogut me Serbinë?

**Hoxha:** E thashë edhe më herët, se dështimi eventual i BE-së, që t'u përmbahet rregullave të veta e që janë rezultatet pas përmbushjes së kriterëve, pra liberalizimi i vizave për qytetarët tanë pas përmbushjes së kriterëve do të vinte në pikëpyetje të madhe besimin tonë karshi BE-së dhe institucioneve të saj. Si mund të jetë garantuese e marrëveshjes me Serbinë një BE që nuk e mban fjalën dhe nuk i përfill procedurat e veta?!

## Bie importi nga Serbia e Bosnja, rriten të hyrat për 300 mijë euro

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Që nga aplikimi i taksës doganore prej 10 përqindësh për mallrat që importohen nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, Dogana e Kosovës ka arritur të grumbullojë rreth 300 mijë euro më shumë. Këto të dhëna i bëjnë me dije për "Radion Evropa e Lirë" zyrtarë të Doganave të Kosovës.

Qeveria e Kosovës një javë më parë ka marrë vendim për vendosjen e taksës doganore prej 10 përqindësh në të gjitha importet me prejardhje nga Serbia dhe Bosnja. Përgjithësisht nga kjo masë bëjnë produktet e brendeve ndërkombëtare të prodhuara në këto dy vende. Drejtori i Doganave të Kosovës, Bahri Berisha, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se ka

pasur rënie të importit prej 50 përqindësh nga dy vendet - Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina. "Krahasimi është bërë një javë para vendimit dhe një javë pas vendimit. Kjo tregon se një javë para vendimit kemi pasur rreth 7 milionë euro produkte të importuara nga këto dy vende, Serbia dhe Bosnja, ndërsa në gjashtë ditët e tjera, pra pas hyrjes në fuqi të vendimit, kemi pasur 3.5 milionë euro importe nga të dyja vendet. Nga taksa mbrojtëse prej 10 përqindësh kemi mbledhur 300 mijë euro", ka deklaruar Berisha. Ai shton se të dhëna më të sakta rreth luhatjes së importeve nga këto dy shtete autoritetet e Kosovës do të kenë pasur për një periudhë trejavëshe.



mbetura. Kurse sa i përket zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asocim, Hoxha ka treguar se është shtuar dukshëm zbatimin e prioritetëve dhe

# Ndërtimtarët po shkaktojnë kaos në trafikun e Prishtinës


**Nga: Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ)**

Një kohë të gjatë trafiku urban dhe ndërurban i Prishtinës është i stërngarkuar me automjete duke e sjellë këtë trafik në gjendje kolapsi. Sidomos trafiku është i stërngarkuar dhe i mbipopulluar me vetura nga ora 7:00 e mëngjesit deri në orën 10:00 dhe nga ora 15:00 deri në orën 18:00 pas dite. Që të jetë edhe më keq, po në kohën kur kemi trafik të stërngarkuar, me kolona të gjata e në disa raste edhe bllokim total, mund të shihen me dhjetëra kamionë që bartin dhe apo materiale të tjera inerte nga kantieret e ndërtimit, deri te vendi ku i shkarkojnë këto materiale. Gjithashtu, mund të shihni dhjetëra "betonjerka" të cilat, përveçse e dëmtojnë

shtresën e asfaltit, lënë prapa vetes edhe betone të mbetura e që pastaj bëhen pjesë e asfaltit duke krijuar shtresa që dëmtojnë veturat e tjera. Mos të flasim edhe për automjete të tjera të rënda për zbrazjen e "betonjerkave" dhe të gjitha këto, së bashku, kontribuojnë shumë në bllokimin e trafikut.

Drejtoritë përkatëse të Komunës së Prishtinës duhet të vendosin rregull në trafikun urban duke shfrytëzuar përvojat e qyteteve të tjera të mëdha e që janë përballur me të njëjtin problem, përkatësisht duhet ta ndalojnë qarkullimin e makinerisë së rëndë të ndërtimit gjatë kohës kur ka stërngarkim, nga ora 7:00-10:00 të mëngjesit si dhe nga ora 15:00-18:00 të mbrëmjes. Ky kufizim do të vlente vetëm gjatë ditëve të punës, kurse jo edhe gjatë fundjavës si dhe ditëve të festave.

Nuk mund të gjeni qytet në Evropë ku makineritë e rënda



për ndërtim qarkullojnë për qendër të qytetit apo me orar të plotë. Ata që pajisen me leje ndërtimi e kanë të caktuar orarin kur këto makineri mund të përdoren sikur edhe rrugët ku mund të lëvizin.

Drejtoritë përkatëse të Komunës së Prishtinës, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës, duhet të gjejnë një zgjidhje sidomos për periudhën dimërore që ta kufizojnë lëvizjen e veturave dhe mjeteve të tjera të transportit duke

kufizuar përdorimin e një veture për një familje gjatë një dite, nëse i kanë dy ose më shumë vetura sikur që edhe të vendoset një taksë e veçantë për ata që me çdo kusht duan të hyjnë me veturë në qendër të qytetit.

Në mungesë të vendeve për parkim, Komuna e Prishtinës duhet t'i shfrytëzojë të gjitha hapësirat publike për parkim me pagesë, përjashtuar këtu banorët e përhershëm në ato lokacione. Në këtë mënyrë do të

kontribuohet për përmirësimin e cilësisë së ajrit, do të zvogëlohet stërngarkimi i trafikut dhe do të krijohet një fond shtesë për mirëmbajtjen e rrugëve të qytetit të Prishtinës.

Me një stërngarkim të trafikut që e kemi tani në Prishtinë, me tendencë të përkeqësimit, me uzurpim të trotuareve dhe hapësirave të tjera, skajshmërisht kufizohet dhe rezikohet lëvizja sikur edhe rritet ekstremisht ndotja e ajrit e që të dyja llogariten si të drejta elementare të njeriut e që shkelen në mënyrë flagrante. Mos të flasim për pasojat për të sëmurët, ndihmën e shpejtë, shërbimi i zjarrfikësve, nxënësit, studentët dhe të punësuarit që nuk kanë qasje të shpejtë për shërbime, shkollim dhe për të punuar.

Përfundimisht, Komuna e Prishtinës, së bashku me Ministrinë e Industrisë, duhet të gjejnë zgjidhje për vendosje të rregullit në trafikun urban dhe ndërurban në Prishtinë.

## Rektori Dema fton studentët të bëhen pjesë e transformimit të UP-së



**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 13 NËNTOR** - Rektori i Universitetit të Prishtinës (UP) "Hasan Prishtina", Marjan Dema, u ka bërë thirrje studentëve të bëhen pjesë e transformimit të këtij universiteti, duke i siguruar që menaxhmenti i UP-së do të jetë çdoherë në dispozicionin e tyre për t'i dëgjuar ankesat, kërkesat dhe idetë për ndryshim. "Në universitetin tonë studenti është në qendër. Në këtë rrugëtim ne dëshirojmë të jeni ju ata që do të

vazhdoni dhe ideoni tutje transformimin e këtij universiteti. Unë pres nga ju shumë angazhim dhe ide në rrugëtimin drejt ndryshimit të UP-së, sepse pa ndryshimin e Universitetit të Prishtinës nuk ka ndryshim të Kosovës", ka deklaruar Dema. Këto komente rektori Dema i ka bërë gjatë një takimi me studentët me të cilët e ka pirë kafënë e mëngjesit.

Ky takim është mbajtur me motot: "Së pari studentët" dhe "Unë jam UP", ku rektori Dema ka diskutuar me studentët lidhur me shqetësimet e tyre dhe idetë

që kanë për përmirësimin e jetës studentore në kompleksin e UP-së.

Studentët e pranishëm në këtë takim, të cilët kanë qenë nga Fakulteti Juridik, Ekonomik, Filozofik, i Edukimit dhe Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, njëzëri janë shprehur të lumtur për takimin me rektorin Dema, ndërkaq idenë për realizimin e një takimi të tillë e kanë konsideruar unike, por edhe shumë të nevojshme për Universitetin e Prishtinës. Ata kanë shprehur idetë e tyre dhe kërkesat për progres në fushën e

mësimdhënies, në kontaktin profesor - student, në fushën e informacionit dhe teknologjisë, e të tjera çështje lidhur me UP-në dhe partneritetin ndërkom-bëtar, për të cilat kanë marrë përgjigje nga rektori dhe ekipi i tij.

Rektori i UP-së, Marjan Dema, në këtë takim ka qenë i shoqëruar nga prorektori për mësimdhënie dhe çështje të studentëve, Hysen Bytyqi, këshilltari juridik Flamur Hyseni dhe asistentja Blerta Dibrani. Kurse studentët pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë: Lirik Veselaj, Fjolla

Vukshinaj, Jeton Rugovaj, Beart Hyseni, Egzon Kelmendi, Muhamed Veliu, Adelina Morina, Flaka Spaqi dhe Dafina Shala.

Takimet e studentëve me rektorin nga tani e tutje do të jenë takime të përmuajshme, gjatë të cilave do të diskutohet për tema të ndryshme që prekin cilësinë e jetës studentore në UP. Ky takim i thirrur nga rektori Dema është organizuar me qëllim që menaxhmenti të jetë sa më i informuar me sfidat e studentëve në përditshmërinë e tyre gjatë studimeve në UP.

# Hapet sesioni informues për aplikimin në programin 'Horizon 2020'

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë të martën në hapjen e sesionit informues për mënyrën dhe mundësitë e aplikimit me projekte shkencore në programin "Horizon 2020", i cili është organizuar nga

Komisioni Evropian. Me këtë rast, ministri Bytyqi ka thënë se shpreson se ky sesion informues për programin më të madh hulumtues në Evropë t'u shërbejë hulumtuesve tanë për të mësuar se si mund të përfitojnë dhe të bëhen pjesë e këtij programi. Ai ka deklaruar se MASHT-i

ka krijuar disa mekanizma institucionalë për përkrahje të hulumtimit dhe shkencës, duke përmendur faktin se MASHT-i financon disa projekte të vogla lidhur me hulumtimet. "Jam i vetëdijshëm që ky është një hap shumë i vogël, por duhet të na shërbejë si një hap, i cili pastaj të

krijojë një mundësi të bashkëpunimit mes përfituesve të këtyre projekteve që ta krijojmë idenë se si t'u qasemi programeve të mëdha siç është "Horizon 2020", është shprehur ai.

Ndër të tjera, ministri Bytyqi ka përmendur edhe miratimin e

rregullores për pikat kombëtare të kontaktit duke shtuar se tashmë janë emëruar personat në këto pika, ndërsa ka përmendur edhe anëtarësimin në COST si anëtar fqinj të parë. Ministri ka shprehur besimin se Kosova ka kapacitete për hulumtim dhe kërkim shkencor.



## Vetëvendosje kërkon nga Telekomu anulimin e kontratës me 'Z-Mobile'

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje kanë mbajtur të martën një konferencë për medie në lidhje me gjendjen në Telekomin e Kosovës. Drejtuesi i Komitetit për Komunikime Elektronike dhe Postare në Vetëvendosje, Fatban Bunjaku, ka folur për vendosjen e njerëzve politikë dhe krejtësisht të papërgatitur në krye të Telekomit të Kosovës siç ishte rasti me kryeshefin ekzekutiv të Telekomit, Gent Begollin, dhe

tash ushtruesin e detyrës, Trim Musliu. "Këtë vit Qeveria Haradinaj emëroi një bord drejtues jokompetent dhe të lidhur në masë të madhe me pushtetin direkt. Më pas emëruan një kryeshef ekzekutiv si Gent Begolli që nuk e njeh as abc-në e qeverisjes së telekomunikacionit. Edhe pse morën kritika e kërkesa nga Kuvendi i Kosovës për ta ndërruar këtë qasje të drejtimit të Telekomit, Qeveria Haradinaj vijoi më tej, duke na lavdëruar e mburrur këtë

menaxhment", ka thënë Bunjaku. Më tutje, ai ka theksuar se qëllimi i kësaj amullie të krijuar tash e sa vjet në Telekom është pikërisht për zhvatjen e 30 milionë eurove përmes përmbarimit për t'i transferuar ato në "Z-Mobile". "Po të ishte ndryshe, sot do të kishim në Telekom menaxhmentin e krizës siç e kërkon rezoluta e Kuvendit e miratuar më 12 korrik 2018. Po ashtu, edhe kontrata me 'Z-Mobile' duhet të ishte e anuluar", ka thënë Bunjaku.

## Kurti: Pa arsim cilësor nuk ka zhvillim ekonomik dhe mirëqenie



PRIZREN, 13 NËNTOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, dhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytahir Haskuka, kanë vizituar të martën shkollën "Loyola Gimnasium" në Prizren, me ç'rast nga drejtori i shkollës, Axel Bodefeld, janë njoftuar për procesin mësimor në këtë shkollë, e cila ka rreth 100 nxënës. Kurti ka përgëzuar personelin e shkollës për punën e deritashme, për edukimin cilësor dhe suksesin e arritur, duke vlerësuar se në këtë shkollë po arsimohen nxënësit të cilëve po u jepet edhe dije, edhe edukim. Ai ka theksuar se pa arsim cilësor nuk ka as zhvillim ekonomik

dhe as mirëqenie shoqërore. Në vazhdim të vizitës në Prizren, Kurti dhe Haskuka kanë vizituar edhe Shoqatën Humanitare "Jetimët e Ballkanit", ku nga themeluesi i saj, Halil Kastrati, janë njoftuar se kjo shoqatë deri më tash i ka strehuar 200 familje, ndërkaq në gjellëtoren e saj rregullisht ushqehen 309 persona. Albin Kurti e ka inkurajuar Kastratin ta vazhdojë punën e bamirësisë që po bën dhe i ka ofruar bashkëpunim të vazhdueshëm, ngjashëm si marrëveshja me Komunën e Prizrenit për ndërtimin e 28 shtëpive, çelësat e të cilave do të jepen më 28 nëntor.



## Transporti publik në kryeqytet vazhdon të jetë falas për pensionistët

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Komuna e Prishtinës në një komunikatë për media ka bërë me dije se ka subvencionuar me 10 000 euro në muaj trafikun urban. Ky subvencionim është bërë me qëllim që pensionistët të mos paguajnë fare biletë në 51 autobusët e transportit publik. "Jemi kujdesur që t'i

lehtësojmë shërbimet për të moshuarit e Prishtinës edhe për çështjen e transportit. Komuna vazhdon ta subvencionojë Trafikun Urban me rreth 10 000 euro në muaj, ashtu që pensionistët të mos paguajnë biletë në 51 autobusët e transportit publik", është thënë në komunikatën e Komunës së Prishtinës.



## Aliu: Ferizaj, ndër qytetet më të qetë në Kosovë

FERIZAJ, 13 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka zhvilluar një takim lamtumirës me përfaqësuesit e LMT-së nga KFOR-i, togeren Allyson McClain dhe rreshterin Isaiah Valdez, të cilët për një kohë punuan në rajonin e Ferizajt, ndërkaq tashmë kanë përfunduar mandatin e tyre. Me këtë rast, kryetari Aliu i ka njoftuar ata

lidhur me zhvillimet e fundit, ndërsa theks të veçantë i ka kushtuar situatës së sigurisë në qytetin e Ferizajt. Ai ka thënë se Ferizaj është një ndër qytetet më të qetë në gjithë Republikën e Kosovës.

Kryetari Aliu ka falënderuar mysafirët për punën e bërë dhe takimet e shumta me qytetarët si dhe projektet e dobishme që janë realizuar. Ndërsa togerja

Allyson McClain, bashkë me ushtarët e tjerë, kanë shfaqur kënaqësinë që kanë qenë të mirëpritur kudo që kanë punuar, duke thënë se po largohen nga këtu me kujtimet më të mira. Në këtë takim mori pjesë edhe ekipi tjetër i LMT-së që do të qëndrojë për një kohë në Kosovë në krye me rreshterin Joe Brown dhe rreshteri Mario Wright.



## Begaj priti në takim nxënësit e 'Bajram Currit' nga Drenoci

MALISHEVË, 13 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, kanë pritur në një takim nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta të Shkollës Filllore dhe të Mësimit të Ulët "Bajram Curri" nga Drenoci. Kjo vizitë e nxënësve është realizuar në kuadër të programit

shkollor të kësaj shkolle. Në këtë pritje kryetari Begaj u ka folur nxënësve për punët dhe shërbimet e institucionit të komunës si dhe për angazhimet e komunës në raport me arsimin dhe shkollat, ndërsa ka kërkuar nga nxënësit të mësojnë dhe të jenë shembull për mësimit dhe të jenë aktivitetet e tjera edukative dhe arsimore.

Nxënësit e kësaj shkolle, në kuadër të programit të tyre, përveç zyrës së kryetarit, e kanë vizituar edhe Asambleenë Komunale të Malishevës si dhe institucionet e tjera kulturore dhe arsimore në qytet, ku janë njoftuar me aktivitetet e këtyre institucioneve. Nxënësit e këtyre klasave janë shoqëruar nga drejtori i shkollës dhe mësuesit e tyre.

## Rehabilitohen disa rrugë në fshatrat e Skenderajt

Skenderaj, 13 nëntor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se është duke u punuar për rehabilitimin e disa rrugëve në tri fshatra të kësaj komune. Në këtë kontekst, ai ka thënë se në fillim të mandatit kishte premtuar se do të intervenojë në çdo pjesë të territorit të Skenderajt. "Me rehabilitimin e rrugëve, duke shtruar zhavorr në rrugët brenda fshatrave Krasmirofc, Kozhicë e Çirez, ku deri sot

është qarkulluar me shumë vështirësi, po ua kthejmë banorëve të fshatrave rreze Qiqavicës dinjitetin e nëpërkëmbur. Janë më shumë se 1 500 metra pjesë të rrugëve të rehabilituara në këto fshatra brenda një jave që mundësojnë qarkullim të lehtë të banorëve. Kam premtuar se do të intervenojmë në çdo cep të territorit të komunës sonë për t'i bërë të kalueshme rrugët e fshatrave. Tani është radha e fshatrave të tjerë", ka thënë Jashari.





## Investimi në të rinjtë, kyçë për suksesin në fushën e ndërmarrësisë

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Përmirësimi i mëtejshëm i elementeve të ekosistemit të ndërmarrësisë, e posaçërisht investimi në kapitalin njerëzor, edhe ruajtja e stabilitetit ekonomik dhe politik, janë kyçë ashtu që përpjekjet e vendit për promovim të ndërmarrësisë dhe inovacionit të kenë sukses. Kështu u tha në tryezën mbi ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm të ndërmarrësisë e cila shënoi edhe aktivitetin e parë pas hapjes zyrtare të Javës Globale të Ndërmarrësisë.

Në tryezën e organizuar nga Innovation Centre Kosovo (ICK) dhe Oda Ekonomike Amerikane

në Kosovë folën ambasadorja e Suedisë, Karin Hernmarck Ahliny, ambasadori i Gjermanisë, Christian Heldt dhe ambasadori i Norvegjisë, Per Strand Sjaastad, si dhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj.

Në panelin e moderuar nga drejtori ekzekutiv i Odës Amerikane, Arian Zeka, u fol për nevojën e eliminimit të dështimeve sistemore që pamundësojnë një ndërmarrësi gjithëpërfshirëse në shoqërinë e Kosovës, identifikimin e potencialeve në të cilat do të mund të bazohet zhvillimi ekonomik i vendit.

Zeka ka falënderuar ambasadorët

e huaj për përkrahjen e Kosovës në përgjithësi, por edhe të Qendrës së Inovacionit përmes së cilës janë përkrahur shumë startupe të suksesshme. Derisa drejtori ekzekutiv i Innovation Centre Kosovo (ICK), Uranik Begu, ndau vlerësimet "Kampionët e Inovacionit" për ambasadorët panelistë si dhe për Ministrinë e Inovacionit. Sa i përket kapitalit njerëzor, si një ndër hallkat më të rëndësishme në zinxhirin e ekosistemit të ndërmarrësisë, u tha se duhet një investim më i madh për trajnimin e të rinjve, derisa u përmend edhe sistemi gjerman dual i edukimit, i cili do të mund të rep-



likohej me sukses edhe në Kosovë. Ambasadori i Suedisë, i Gjermanisë dhe i Norvegjisë shprehën optimizëm për të

ardhmen e Kosovës në fushën e ndërmarrësisë, derisa zotuan përkrahjen e tyre të vazhdueshme në këtë drejtim.

## Ministria e Mjedisit paralajmëron masa për ndalimin e shitjes së thëngjillit

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, gjatë raportimit para Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, lidhur me gjendjen e mjedisit në Kosovë, ka bërë me dije se do të konfiskohet i gjithë thëngjilli që gjendet për shitje në rrugët e kryeqytetit. "Jemi në plan të përgatitjes së aksioneve të njëpasnjëshme për konfiskimin e thëngjillit kudo nëpër rrugët e Prishtinës. Para se të vij këtu takova edhe inspektorin dhe kryeinspektorin. Shpeshherë ka pengesa në punë edhe për shkak të mospërgjegjës me kohë nga ana e policisë dhe inspektoratit. Megjithatë, besoj se në ditët në vijim do të ketë aksione për konfiskim të thëngjillit kudo që gjendet në rrugët e Prishtinës", ka deklaruar ai. Matoshi ka thënë se së shpejti do të aktivizohet edhe 'Policia e Gjelbër', pasi janë identifikuar probleme gjatë zbatimit të detyrave. Sipas tij, gjendja e mjedisit për vitin 2017 tregon për një gjendje jo të mirë përkundër përpjekjeve për mbrojtjen e tij. Po sipas tij, në ndotjen e ajrit ka ndihmuar edhe dhënia falas e thëngjillit për punëtorët e KEK-ut.



Ndërsa kryeshefi i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, Ilir Morina, ka thënë se tejkalimet e ndotjes së ajrit kanë filluar para tri javësh. Morina ka treguar edhe faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në vend, ku vëmendje të posaçme i kushtoi përdorimit të 'peletit', për të cilin tha se mund të jetë më i rrezikshëm sesa thëngjilli. "Energjetika është numër një. Dhe, ndotësi më i madh si burim, jo për Prishtinën, po për Kosovën, janë termocentralet e

'Kosovës A', pastaj vijnë burimet e tjera energjetike, siç janë transporti, automjetet dhe shtëpitë. Kemi ngritje të oksideve të azotit, që do të thotë rrjedhë nga djegia e lëndëve të automjetit, që vijnë nga karburantet jociësore dhe vjetërsia e automjetit. Shumica e automjeteve janë shumë të vjetra, nuk kanë katalizatorë ose u janë hequr", është shprehur Morina. Kryetari i Komisionit, Muharrem Nitaj, u shpreh i pakënaqur që

deri në muajin prill nuk do të kenë një raport të detajuar. Ndërsa pati edhe pyetje për ministrin Matoshi. "Ne e kemi problemin që jemi në fillim të dimrit dhe ndotja e ajrit në këtë periudhë është më e rënda, qysh ka qenë edhe vitin e kaluar. A e keni shqyrtuar që të bëhet ndërprerja e përdorimit të thëngjillit edhe në banesat kolektive?!", ka pyetur Nitaj. Në përgjigjen e tij, Matoshi ka deklaruar se nuk kanë mundur të

marrin një vendim të tillë për shkak se thëngjilli është përdorur edhe në institucione publike. Ai theksoi se janë marrë vendime për ndalimin e përdorimit të thëngjillit edhe nga institucione përkatëse siç është MASHT-i. Ai shprehu optimizëm se ndalimi i dhënies së thëngjillit për punëtorët e KEK-ut do të ndihmojë në uljen e ndotjes së ajrit në vend, pasi ky thëngjill shpeshherë, sipas tij, pati përfunduar me shitje.

## MTI-ja kërkon nga prindërit që t'i largojnë lodrat e rrezikshme nga fëmijët

PRISHTINË, 13 NËNTOR (ER) - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke punuar vazhdimisht që produktet në treg të jenë cilësore dhe në harmoni me legjislacionin evropian. Në vazhden e kontrollit të produkteve që shiten apo tregtohen në tregun e Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë muaj më parë ka marrë mostra të lodrave dhe ka dërguar për analiza në Holandë.

Pas pranimit të rezultateve, inspektorati i tregut ka larguar nga tregu lodrat e rrezikshme dhe i ka asgjësuar ato. "Gjithashtu, kemi bërë takime të vazhdueshme dhe kemi dërguar informacione tek inspektoratet komunale që edhe në fshatrat më të thella të bëhet një inspektim i tillë dhe nëse gjenden lodra të tilla të largohen nga tregu. Duke pasur parasysh se këto lodra të lartcekura kanë qenë në

përdorim për një kohë të gjatë në Republikën e Kosovës dhe mund të gjenden edhe në shtëpitë tona, MTI-ja njofton të gjithë qytetarët se këto lodra janë të rrezikshme në bazë të analizave që i kemi bërë në laboratorin SGS në Holandë, kërkojmë nga ju që sa më shpejt t'i largoni nga shtëpitë dhe t'i asgjësoni", është thënë në njoftimin e MTI-së.



# ARRITJA DHE QËNDRUESHMËRIA E PAQES



**PhD Salihe SALIHU**

Më 11 nëntor të këtij viti u shënua Dita e arritjes së Paqes pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Franca aranzhoi një manifestim të nivelit ndërkombëtar në vendin Rhetondes në afërsi të qytetit Compiègne. Pikërisht në vendin ku në vitin 1914 kishte

kapitulluar Franca në të njëjtin vend në vitin 1918 kishte kapitulluar Gjermania e Hitlerit. Në këtë manifestim ishin përfaqësues nga gjashtëdhjetë vende të botës të cilët me praninë e tyre ndikonin në qëndrimin e tyre se janë pruarjtjes së paqes. Mirëpo veçantia apo specifika e këtij manifestimi është karakterizuar me veprime unike, apo mund të emërtojmë veprime që shënojnë kthesa historike. Veprimi i parë që duhet të veçohet është prania e Gjermanisë në këtë manifestim. Për herë të parë, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore para njëqind vjetëve,

merr pjesë një lider gjerman. Paqja në mes të Francës dhe Gjermanisë është e konsoliduar dhe e qëndrueshme, por paraqitja publike e liderëve gjermanë në këtë manifestim tregon reflektimin e shtetit gjerman për të kaluarën e largët, duke dëshmuar se krenaria e sëmure gjermane vdiq më 11 nëntor 1918. Përpos kësaj, me këtë paraqitje liderët gjermanë shfaqin edhe vullnetin dhe rrisin shpresat se politikat ndërkombëtare janë të përkushtuara dhe të angazhuara për të ruajtur një paqe të qëndrueshme në botë. Veprimi i dytë që, po ashtu,

llogaritet si veprim unik dhe kthesë historike, është pjesëmarrja e shtetit tonë për herë të parë si shtet i pavarur dhe sovran në një manifestim paqejë të nivelit ndërkombëtar. Përveç pranisë së përfaqësuesve të shtetit të ri të Kosovës u arrit edhe një takim i përmasave mjaft domethënëse, pra takimi i liderit rus dhe kosovar. Ky takim që deri më tani dukej si i përealizueshëm në kanale apo takime të zakonata, u bë i mundshëm dhe i arritshëm në një manifestim paqejë. Në një atmosferë të dominuar për përkrahje simbolike të qëndrueshmërisë së paqes ky takim mund të

lexohet dhe interpretohet që Kosova dëshiron paqe dhe kërkon përkrahjen edhe të Rusisë e cila vazhdimisht ka pasur kundërthënie dhe ka hezituar që ta përkrahë paqen në Ballkan, në veçanti paqen në mes të Kosovës dhe Serbisë. Shikuar nga vlerësimi i perspektivës së politikologjisë me elemente të gjykimit neutral, ky ishte një mesazh i dhënies shpresë së diskursit të paqes, që treni i luftës që dikur barte ushtarë e armatime për të luftuar tani do të bartë misionarë që do kontribuojnë paqes. Me këtë jepet mesazhi që arritja e paqes duhet të jetë e qëndrueshme!

## MESAZHI NGA TAKIMI THAÇI - PUTIN: MUND TË KEMI NJË NJOHJE TË KUSHTËZUAR NGA RUSIA, POR NUK DUHET TË EKZALTOHEMI AS TA KRYQËZOJMË THAÇIN!?



**Shkruan: Ramadan BARALIU**

Takimi "bilateral" Thaçi - Putin në margjina të Forumit të Paqes në Paris është lëvizje pozitive e Rusisë në raport me Kosovën. Edhe pse e drejta ndërkombëtare nuk e pranon nocionin e njohjes de facto të kushtëzuar, dhe kemi raste të rralla të njohjes de facto, por kemi disa raste në histori kur ka pasur njohje të kushtëzuar. Siç ka qenë me disa shtete ballka-

nike dhe njohja e Bashkimit Sovjetik nga ShBA-ja më 1933. Duke e luajtur rolin e optimistit më të madh për këtë situatë, pas presidentit Thaçi dhe disa dostave të tij, nga ky takim mund të themi se kemi një njohje de facto të kushtëzuar nga Rusia e transmetuar nga presidenti Thaçi. Por, gjendja nuk mund t'i referohet krijimit të faktit se Rusia do ta pranojë Kosovën de facto apo de juro së shpejti. Kjo njohje kushtëzohet me atë që Serbia duhet ta pranojë Kosovën pas një marrëveshje me siguri tepër të dhimbshme për Kosovën dhe me proces me siguri me prapaskena mes Rusisë dhe Serbisë. Proces me shumë të panjohura dhe shumë mosbesues edhe për optimistin më të

madh. Por, nuk ka nevojë për ekzaltime pasi që nuk dihet se si do të përkthehet ky takim, përderisa të shihen rezultatet në terren dhe cila do të jetë marrëveshja përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë dhe a do të ketë një të tillë. Po ashtu nuk ka hapësirë për gozhdimin e Presidentit Thaçi, pasi nuk mund të lëvizim drejt OKB duke refuzuar takimet me shtet që e kanë të drejtën e vetos në KS të OKB. Por, as presidenti nuk duhet ekzaltuar dhe të lëshohet në aventura me Serbinë e Rusinë, duke e njohur historikisht qëndrimin e tyre kundër nesh. Tani mbetet që të krijohet një platformë shtetërore për këtë proces të rëndësishëm që tash-

më ka hy vendi përmes Presidentit Thaçi. Na duhet një platformë shtetërore për procesin e normalizimit të raporteve me Serbinë dhe përmbylljen e subjektivitetit ndërkombëtar! E drejta ndërkombëtare njih dy forma të njohjes: de facto dhe de jure. Njohja de facto e shteteve, në vend të de jure, është e rrallë. Njohja de jure është më e fortë, ndërsa njohja de facto është më shumë tentative dhe njeh vetëm se një qeveri ushtron kontroll mbi një territor. Pas takimit "bilateral" Thaçi-Putin në margjina të Forumit të Paqes në Paris, kemi një njohje ta quajmë kështu de facto të kushtëzuar me normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë që

mund të bëhet de juro. Pra nuk është as njohje de facto, pasi që Rusia vazhdon ta dënoj shpalljen e pavarësisë së Kosovës si akt në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe precedent të rrezikshëm për sistemin ndërkombëtar dhe nuk kemi asnjë deklaratë zyrtare që ka lëvizje në këtë drejtim. Rusia mbështet Kushtetutën e Serbisë që e përfshinë Kosovën dhe Rezolutën 1244 e Këshillit të Sigurimit. Kjo rezolutë e përcakton statusin politik të Kosovës si protektorat të OKB-së, Edhe pse rezoluta e bën Kosovën protektorat të OKB-së, në këtë rezolutë disa herë përmendet se Kosova është pjesë e Jugosllavisë. Si do të rrjedhin ngjarjet mbetet të shihet.

## Policia sekuestron 131 vetura të peregjistruara në Kosovë

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar - Njësia për Hetimin e Autokrimeve, në bashkëpunim me Doganën e Kosovës dhe njësitë e tjera policore, ka ndërmarrë një operacion të gjerë policor të quajtur "Targat". Gjatë këtij operacioni policor, i cili është shtrirë në tërë territorin e Kosovës, janë sekuestruar mbi 130 vetura të peregjistruara. "Operacioni policor i zhvilluar nga data 15. 10. 2018 deri më 12. 11.

2018 ka rezultuar me kontrollimin e një numri të madh të veturave, në mesin e të cilave janë sekuestruar 131 vetura të cilat janë dërguar në Doganat e Kosovës për vazhdim të procedurave doganore. Po ashtu, janë konfiskuar edhe dy vetura që dyshohet se janë të vjedhura", është bërë me dije në njoftimin e Policisë së Kosovës. Policia ka paralajmëruar se do t'i vazhdojë aktivitetet e tilla edhe në të ardhmen në mënyrë që veprimet e tilla antiligjore të minimizohen dhe rrugët të jenë më të sigurta në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i vendit.





## Trumpi sulmon presidentin francez

UASHINGTON, 13 NËNTOR - Presidenti amerikan, Donald Trump ndërmori sulme verbale të martën ndaj Francës dhe presidentit të saj, Emmanuel Macron, duke përmendur sondazhet që flasin për mbështetje të ulët ndaj tij dhe duke kritikuar ashpër tarifën franceze ndaj eksportit të verës amerikane si dhe faktin që Franca nuk e ka plotësuar objektivin për shpenzimet e mbrojtjes për NATO-n. "Emmanuel Macron sugjeron

ndërtimin e një ushtrie të vet për të mbrojtur Evropën nga Shtetet e Bashkuara, Kina dhe Rusia", shkruante presidenti Trump në Twitter.

"Por ishte Gjermania në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore si funksionoi kjo për Francën? Ata filluan të mësojnë gjermanisht në Paris, para se të arrinin amerikanët. Paguaj ose mos paguaj për NATO-n!", tha ai. Trumpi i ka sulmuar vazhdimisht aleatët e Amerikës

në NATO, pasi nuk e kanë plotësuar objektivin për të shpenzuar 2 për qind të ekonomive të tyre kombëtare për mbrojtjen, kryesisht për armë dhe forca të armatosura.

Ndërsa presidenti Trump e ka deklaruar veten "nacionalist" të dielën në Paris, presidenti francez Macron, ndërsa Trumpi dëgjonte pranë tij, e denoncoi nacionalizmin në rritje në gjithë botën, duke e quajtur atë "një tradhti ndaj patriotizmit".



# Demokratja Kyrsten Sinema fiton garën e ngushtë në Arizona

Demokratja Kyrsten Sinema pas numërimit të votave në Arizona fitoi garën për Senat ndaj kandidates republikane, Martha McSally me një epërsi prej afro dy për qind të votave

Uashington, 13 nëntor - Partia Demokratike në Shtetet e Bashkuara siguroi një vend tjetër në Senat, të hënën në mbrëmje, pasi përfundoi numërimi i votave në Arizona, që zgjati thujse një javë që nga data e zgjedhjeve më 6 nëntor.

Kyrsten Sinema fitoi garën ndaj kandidates republikane, Martha McSally me një epërsi prej afro dy për qind të votave, Ajo e uroi Sinema me një videomesazh në Twitter.

Demokratja Sinema u shpall fituese, gjashtë ditë pas zgjedhjeve.

"Arizona hodhi poshtë atë që është bërë normë në vend: shartjet, sulmet personale dhe bërjen e gjithçkaje vetëm e vetëm për t'u zgjedhur. Është e rrezikshme dhe na ul si vend. Por Arizona provoi se ja një mënyrë më të mirë për të

ecur përpara", tha ajo.

Sinema do të jetë senatorja e parë grua e Arizonës dhe do të zëvendësojë senatorin republikan Jeff Flake që po del në pension.

Gara e Arizonës ishte njëra nga dy garat për Senatin, rezultatet e së cilave nuk ishin shpallur pas zgjedhjeve për Kongresin të së martës së kaluar.

Një garë në Misisipi po shkon drejt një rundi të dytë më 27 nëntor.

Ndërkohë autoritetet amerikane të zgjedhjeve vazhduan të numëronin dhe rinumëronin të hënën numrin e përgjithshëm të votave në disa zgjedhje rezultati i të cilave nuk është shpallur, afro një javë pas votimeve për kongresin.

Vëmendja më e madhe është përqendruar në shtetin e



Floridës, ku rezultati është në dyshim në dy gara ku republikanët kanë një epërsi të lehtë.

Në një garë për Senatin, guvernatori i Floridës, Rick Scott po ruan një epërsi prej 12 mijë e 500 votash ndaj senatorit aktual demokrat, Bill Nelson, ndërsa në

garën për postin e guvernatorit

për të zëvendësuar Scott, kongresisti Ron DeSantis ka një epërsi prej 34 mijë votash ndaj kryebashkiakut demokrat të kryeqytetit të shtetit, Andrew Gillum. Presidenti Donald Trump, që bëri fushatë disa herë për kandidatët Scott dhe DeSantis, tha se rinumërimi i votave në Florida është i manipuluar dhe duhet të ndërpritet, duke deklaruar fitues dy republikanët pasi kishin epërsi, kur u shpallën rezultatet të martën e kaluar.

"Rezultatet e zgjedhjeve në Florida duhet të shpallen në favor të kandidatëve Rick Scott dhe Ron DeSantis, pasi një numër i madh fletësh të reja votimi u shfaqën papritur dhe shumë fletë votimi nuk gjenden ose janë manipuluar. Një numërim i drejtë votash nuk

është më i mundur. Duhet të pranohen rezultatet e natës së zgjedhjeve", shkruante presidenti në Twitter.

Demokrati Gillum, me mesazhin e tij në Twitter, reagoi ndaj Trumpit për zgjedhjet e Floridës, duke iu përgjigjur "Dukesh nervoz".

Zyrtarët e zgjedhjeve po numërojnë vota edhe në disa gara të tjera, përfshirë për disa vende të Dhomës së Përfaqësuesve dhe postin e guvernatorit në shtetin e Xhorxhias.

Në Xhorxhia, kandidati republikan Brian Kemp, ka një epërsi prej 58 mijë votash ndaj rivalës së tij demokrate, Stacey Abrams, një ligjvënese e legjislaturës së shtetit, që po kërkon të bëhet e para guvernatore afrikano-amerikane e shtetit.

## Merkeli mbështet krijimin ushtrisë evropiane

STRASBURG, 13 NËNTOR - Kancelarja gjermane, Angela Merkel i dha mbështetje nga ana e saj, përpara Parlamentit Evropian në Strasburg, krijimit të një ushtrie të vërtetë evropiane, menjëherë pas polemikave të krijuara për këtë çështje midis Donald Trump dhe Emmanuel Macron.

"Duhet të hartojmë një vizion që do na mundësojë një ditë të kemi një ushtri të vërtetë evropiane", deklaroi Merkeli përpara eurodeputetëve ku pati duartrokite dhe mosaprovim gjatë fjalimit.

Kancelarja gjermane rikujtoi gjithashtu se kishte propozuar krijimin e një këshilli të sigurisë evropi-



ane me presidencë të radhës, ku do të mund të merren vendime të rëndësishme në mënyrë të shpejtë.

## Arrihet marrëveshje për draftin e parë të Brexit-it

LONDER, 13 NËNTOR - Kryeministrja britanike, Theresa May pritet të udhëheqë një takim të veçantë të kabinetit të saj lidhur me marrëveshjen për Brexit. Një burim nga kabineti i ka thënë BBC-së se teksti është miratuar nga zyrtarët në një

nivel teknik nga të dyja palët pas bisedimeve intensive këtë javë.

"The Sun" ka raportuar se secilit ministër i është kërkuar të takojë kryeministren ndaras në mbledhjen e të martës.

Në negociatat e së martës e ardhmja e kufirit irlandez ka

qenë çështja kyçe për diskutim.

Ministrat kanë thënë më herët se ata do të publikonin një "deklaratë të plotë ligjore" para se të votonin ndonjë marrëveshje finale.

Në referendumin e 23 qershorit më 2016, 17.4 milionë

persona apo 51.9 për qind e votuesve kanë përkrahur largimin nga BE-ja derisa 16.1 milionë të tjerë apo 48.1 për qind të tjerë kanë votuar kundër Brexit-it.

Britania pritet të largohet nga blloku evropian në mars të vitit 2019.



Me rastin e 110-vjetorit të krijimit të alfabetit të gjuhës shqipe. Një përvjetor i ndritur

# KONGRESI I MANASTIRIT, VEPËR ELITARE E HISTORISË KOMBËTARE

Gjergj Fishta shkroi: "Alfabeti i vetmi mjet me të cilin kombi do të përparojë. Po të mos zgjidhej alfabeti, Shqipëria do të pësojë humbje të mëdha, madje është e parëndësishme se cili do të jetë ai, por ta kemi një"



Hasan MUJAJ

Kongresi i Manastirit filloi punën më 14 dhe përfundoi më 22 nëntor të vitit 1908. Ai, pas pavarësisë së dy shteteve shqiptare, Shqipërisë e Kosovës, që dhe mbeti arritja më kontemplative e më mbresuese e historisë së vullshme dhe dinamike gjatë Rilindjes Shqiptare në të cilën (arritje) u themelua alfabeti i gjuhës shqipe, i kësaj vlere më të lartë kombëtare dhe identitare.

Pas botimit të disa gazetave e revistave në gjuhën shqipe, pas hapjes së disa shkollave në gjuhën shqipe që thelluan e zgjeruan idealet e frymës iluministe të programit nacional të Rilindjes Kombëtare, tani, si detyrë sipërore e shoqërive kulturore propagandistike dhe në tërësi si pikësynim prioritar i lëvizjes kombëtare brenda e jashtë Shqipërisë, në kolonitë shqiptare të mërgimit, që krijimi i një alfabeti unik për gjuhën shqipe, e cila, asokohe, shkruhej me disa alfabe.

Alfabeti unik që domosdoshmëri e kohës, prandaj Kongresi i Manastirit, që si kryetemë vuri çështjen e alfabetizimit të gjuhës, u prit me entuziazëm të lartë e me përjetime emfatike jo vetëm nga pjesëmarrësit, por nga shqiptarët në përgjithësi.

Krijimi i këtij alfabeti e shpuri përpara zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të çështjes arsimore, kulturore, publicistike të lëvizjes shqiptare për të drejtat nacionale dhe për ndërtimin e shtetit shqiptar. Kongresi i Manastirit u organizua dhe u mbajt në rrethana të ndërlikuara politike, kombëtare, ndërkombëtare etj. Ai kishte marrë në trajtim një çështje me rëndësi të veçantë arsimore, shkencore e kombëtare: përpil-

imin e alfabetit të gjuhës shqipe, i cili shënoi stabilizim dhe avancim të çështjes gjithëkombëtare.

Zhvillimet dhe rrethanat e ndera politike, sidomos në historinë e përndjekur të kulturës sonë nga qarqet antishqiptare, kanë penguar zhvillimin e arsimit, të përdorimit të gjuhës shqipe e të alfabetit të saj, ashtu sikundër kanë ndikuar edhe në thellimin e dallimeve gjuhësore e kulturore mbi baza rajonale e sociale brendashqiptare.

Çështja e njësimi të alfabetit të gjuhës shqipe, që nga fillimi i Rilindjes Kombëtare, me të drejtë ishte parë si kërkesë me shumë interes shkencor, arsimor e kombëtar, prandaj me shumë arsye u mor nisma që drejtuesit e shoqërive e klubeve kulturore, të cilët kishin alfabe të ndryshme për të shkruar gjuhën shqipe, të ftoheshin në një takim kombëtar që do të quhej kongres për të krijuar një alfabet të vetëm.

Shkrimtarët dhe studiuesit e periodës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, krijimin e një alfabeti të gjuhës shqipe, nuk e shihnin vetëm si çështje thjesht gjuhësore, por edhe si çështje me rëndësi të madhe kombëtare. Sepse, përdorimi i shumë alfabeve krijonte edhe ndasi ndërshqiptare dhe ishte si pengesë e bashkërendimit të veprimtarisë kulturore, arsimore e politike në interesin e çështjes shqiptare. Pati rëndësi të madhe fakti se njësimi i alfabetit u pa si kërkesë e ngutshme e kohës për ta bërë tok konsolidimin gjithëkombëtar.

## Gjuha shqipe, mjet i unitetit kombëtar

Kongresi i Manastirit nuk që vetëm Kongres i alfabetit të gjuhës shqipe. Jo. Ai që shumë më i gjerë, shumë më domethënës. Kjo nga fakti se me të drejtë gjuha shqipe ishte parë si mjet i pazëvendësueshëm i zgjimit dhe i thellimit të vetëdijes kombëtare dhe i unitetit kombëtar, ngase, sikundër

kishte vënë re Sami Frashëri, mospërdorimi i gjuhës shqipe, sjell asimilimin.

Prandaj, këtij takimi të rëndësishëm historik e gjithëkombëtar i kanë paraprirë disa shtysa, të cilat patën ndikim të madh në pikëpamjen e intensifikimit e të zhvillimit të veprimtarisë së mëtejshme kombëtare.

Njëra nga shtysat parësore që bëri jehonë të madhe jo vetëm në zgjimin dhe thellimin e vetëdijes kombëtare, por edhe në afirmimin e çështjes shqiptare në relacionet ndërkombëtare që Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në programin kombëtar të së cilës përdorim dhe zhvillimit të gjuhës shqipe, i jepej rëndësi e veçantë. Relevanca e gjuhës shqipe nga rilindësit ishte parë nga një horizont më i gjerë, më shumë se thjesht gjuhë: ishte parë si themel i kompleksitetit dhe i unitetit gjithëkombëtar.

Pa u bërë një vit nga mbledhja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, krijuesit zulmëmëdhën të Rilindjes Shqiptare, në rrjedhën e përpjekjeve pragmatike për t'i sendërtuar kërkesat e Lidhjes ndër të cilat qenë edhe përdorimi i gjuhës shqipe dhe çështja e alfabetit të saj, themeluan në Stamboll "Shoqërinë e të shtypurit shkronja shqip" dhe hartuan një alfabet të gjuhës shqipe që hyri në histori me emrin Alfabeti i Stambollit (më 1879).

Autorët e këtij alfabeti qenë: Sami Frashëri, Jani Vreto e Pashko Vasa dhe ndoqën parimin një tingull, një shenjë grafike. Zhvillimi i arsimit në gjuhën shqipe dhe përpilimi i një alfabeti unik për gjuhën shqipe qenë dy prioritetet më të mëdha të përfshira në programin e lëvizjes kombëtare shqiptare. Krijimi i një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe u bë çështje e ndërlikuar dhe vështirë e sendërtuar për arsye se ai jo vetëm që pengohej nga pushtuesit osmanë, por pati pengesa edhe nga kundërvëniet ndërshqiptare si rrjedhojë e mentalitetit primitiv të përçarjeve krahinore, të konkurrencës së shoqërive kulturore e të veprimtarisë kombëtare të mbi katërdhjetë klubeve shqiptare të kohës. Megjithëkëtë, formimi i një alfabeti zuri vendin qendror, prandaj më 21 gusht 1908, klubi "Bashkimi" i Manastirit, kryetar i të cilit ishte Fehim Zavalani, pas një bashkërendimi pararendës, mori vendim që

Kongresi i Manastirit të fillonte më 14 nëntor 1908 në të cilin do të ftoheshin delegatë të të gjitha klubeve e shoqërive kulturore si dhe intelektualë e studiues të shquar.

Propaganda mediale e disa shteteve me politikë anti-shqiptare u përpoq të zgjonte reagime e kundërshtime ndërkombëtare kinse Kongresi po ftohej për të shqyrtuar shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë; shkruhej se "shqiptarët janë barbarë", "të paqytetrueshëm", se "janë për t'u shpërndarë" etj. Me gjithë shkrimet e këtilla tendencioze, Kongresi filloi punën. Në të morën pjesë tridhjetë e dy delegatë me të drejtë vote që "përfaqësonin njëzet e gjashtë qytete e shoqëri brenda e jashtë Shqipërisë".

Në fillim të punës u lejua pjesëmarrja e shumë ithtarëve të njësimi të alfabetit që përbënin "rreth katërqind veta". (Shaban Demiraj/Kristaq Prifti, Kongresi i Manastirit, Tiranë, 2004.)

Kryetar i Kongresit të Manastirit u zgjodh intelektual i virtuoz e atdhetari i shquar, Mit-hat Frashëri (sot shkruhet Mithat), (Lumo Skëndoja), nënkryetarë: Luigj Gurakuqi e Gjergj Qiriazi, sekretarë: Hilë Mosi, Thoma Avrami dhe Nyzhet bej Vrioni.

Kongresi zgjodhi me vota të fshehta komisionin për të marrë vendim për alfabetin të përbërë nga njëmbëdhjetë anëtarë. Pasi mori numrin më të madh të votave të Kongresit, Gjergj Fishta u caktua kryetar i komisionit. Komisioni, sipas shënimeve të ruajtura, vendosi të formohej alfabeti i shqipes mbi bazën e alfabetit latin me përshatje të caktuara fonetike. Ai vendosi njëzëri t'i përshtaste dy alfabe: të Bashkimit të Shkodrës dhe të Stambollit, të ngjashëm me njëri-tjetrin dhe të dy, alfabe të mbështetura në alfabetin latin. Kongresi tumiri vendimin e komisionit. Kështu numri i alfabeve tani u reduktua në dy. Kjo arritje davariti ndasitë e deriatëhershme të shqiptarëve rreth alfabetit.

## Imperativ i kohës: shkollat dhe alfabeti

Këto dy synime kombëtare, shkollat dhe alfabeti, duke qenë si përbërës themeltarë të identitetit kombëtar, morën shtrirje të gjerë në të gjitha krahinat

shqiptare dhe në të gjitha shtresat shoqërore. Ky fakt d.m.th. fakti se gjuha shqipe ishte parë si mjet i zhvillimit shoqëror në të gjitha fushat e veprimtarisë, fakti se për shkollat shqipe dhe për alfabetin e gjuhës shqipe nuk vepronin vetëm qarqet intelektuale, por edhe shtresat, klasat dhe grupet e ndryshme shoqërore, dëshmojnë bazën e gjerë të kompleksit sociolinguistik të veprimtarisë së thukët për çështjen e alfabetit të gjuhës shqipe, e cila kundrohej jo vetëm si çështje shkencore, porse trajtohej edhe si çështje e civilizimit kombëtar, si argument i njohjes ndërkombëtare në shumë pikëpamje si në atë arsimore, kulturore, politike etj. Sami Frashëri e kishte parë shumë drejt aspektin e lidhjes së pandarë të gjuhës me shoqërinë, d. m. th. aspektin sociolinguistik. "Të moslëvruarit e gjuhës amtare, sigurisht, e ka favorizuar procesin e asimilimit të një pjese të shqiptarëve..." shkruan ai. Samiu mbronte tezën e drejtë që alfabeti i shqipes të kishte bazën në alfabetin latin për të shtuar se Shqipëria është "vend evropian dhe populli shqiptar është një popull evropian".

Edhe Kostandin Kristoforidhi, në vitin 1888, shkruante: "Ndë mos u shkroftë gjuha shqipe edhe sot mbë këtë ditë nuk do të ketë më Shqipëri ndë faqe të dheut..." (Vepra e cit., f. 30).


Kristoforidhi me arsye gjuhën shqipe e alfabetin e saj i sheh si tregues të genies, të arsimimit e të zhvillimit kombëtar.

Në ftesat që klubi shqiptar "Bashkimi" i Manastirit ua kishte dërguar klubeve dhe shoqërive kulturore brenda e jashtë Shqipërisë për të marrë pjesë në Kongresin e Manastirit vihej në dukje vlere e madhe kombëtare, historike e zhvillimore që e kishte hartimi i një alfabeti të gjuhës shqipe. Aty, ndër të tjera, shkruante: "Interesi kombëtar lyp nevojën e njësimi të alfabetit të gjuhës sonë për përparimin dhe lumturimin e popullit tonë". Alfabeti "ka me forcue fletët ma të shkëlqyeshme të historisë sonë kombëtare; alfabeti i gjuhës që është çelësi i plotësimi të të tanë nevojave qytetërore e të përparimit industriuer, për neve sot është një nga nevojat e para me rëndësi" (Aty, f. 30). (Vijon)

**E rrallë**

## Shkëmbi në formë të elefantit

Në ishujt Westman të Irlandës gjendet një shkëmb në formë të elefantit. Ky gur vullkanik është formuar nga erupsioni dhe i gërryer nga erozioni dhe nga kjo ka marrë formën e elefantit. Shkëmbi gjendet 4.4 milje larg bregut jugor të Irlandës, Westman përbëhet nga 15 ishuj.



**FOTO E DITES**



Varka më e gjatë e dragoit në botë lundron përgjatë lumit Mekong në Kamboxhia. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

## "Hotelet" e bletëve

Në botë numri i bletëve është duke u zhdukur si pasojë e pesticideve, urbanizmit dhe prerjes së lartë të pyjeve. Por në Amsterdam të Holandës po ndodh e kundërta, pasi bletët janë shtuar në masë të madhe, për arsye se atyre po u bëhet akomodim luksoz në "hotele". "Hotelet" janë të ndërtuara nga vrima të vogla të drurit dhe janë të mbushura me materiale të cilat emitojnë vendbanimin natyral të bletëve, ato hyjnë aty dhe lirojnë vezët e tyre. Kjo metodë ka ndihmuar në rritjen e numrit të bletëve në Amsterdam.



## BARSOLETA E DITËS



Pas një zënke plot bërtitje dhe sharje, burri i thotë gruas:  
- Ti je si droga!  
- Tash po përpiqesh të më marrësh me të mirë. Do të thuash se jam si droga, që nuk mundesh pa mua e gjëra të tilla.  
- Jo, jo. Dua të them se ma ke shkatërruar jetën.



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### "ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

#### "JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

#### "NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

#### "SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

#### "VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
Regjia: Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), fb: Kino ABC.



**DASHI**

Dita sot që në orët e para të mëngjesit


nuk paraqitet fare e mirë. Do të keni për të thënë gjithçka që ju ndodh dhe jeni mjaft të nervozuar.



**DEMI**

Sot do të sheshohen të gjitha mosmar-

rëveshjet që keni pasur në sektorin e punës. Do të dini të gjeni zgjidhje edhe aty ku problemet duken mjaft të mëdha.



**BINJAKËT**

Jeni pak të dyzuar sot lidhur me çfarë duhet

të bëni dhe do të kërkonit këshilla. Dini se kujt t'i drejtoheni në kësi rastesh.



**GAFORRJA**

Sot po arrini drejt përfundimit të një

projekti vërtet të rëndësishëm për ju. Jeni të mbushur plot optimizëm që gjërat e mira realizohen gjithmonë.



**LUANI**

Sot do të jetë e rëndësishme të

mos lëndoni askënd, por një fjalë e thënë pa u menduar do t'i shkaktojë shumë mëzri një mikut tuaj.



**VIRGJËRËSHA**

Është momenti t'i rishikoni në detaje

hapat e marrë në fusha të ndryshme të jetës. Mbase duhet të bëni hapa pas një një fushë të caktuar.



**PESHORJA**

Sot duhet të gëzoheni edhe për

gjërat e vogla. Mos hezitoni ta shfaqni buzëqeshjen tuaj kudo ku keni mundësi.



**AKREPI**

Nëse nuk ndiheni mirë me veten sot, nuk

duhet të merrni përsipër përgjegjësi që mbase në të ardhmen do t'ju kthehen kundër.



**SHIGJETARI**

Ata që kanë besim te ju sot do t'ju

kërkojnë mbështetje për një çështje të caktuar.



**BRICJAPI**

Sot mund t'ju dalin vështirësi që nuk i

kishit menduar më parë. Mbrëmje e qetë në shoqërinë e partnerit që do t'ju bëjë ta harroni ditën e ngarkuar.



**UJORI**

Do të krijoni përvoja të reja dhe

fitimprurëse në fusha që ju nuk i kishit menduar aspak. Mjafton pak kurajë dhe çdo gjë zgjidhet.



**PESHQIT**

I keni zbuluar ndjenjat tuaja


personave pranë jush dhe nuk po e kuptoni keni bërë mirë apo keq, duke parë situatat që po ndodhin.

## Alexander Skarsgard e do një britanike për grua



**A**lexander Skarsgard së fundmi ka treguar se është beqar, por ai ka vendosur që gruaja e tij të jetë britanike. "Nga një moshë shumë e hershme, gjithmonë kam menduar se do të përfundoj me një britanike. Ka të bëjë me mentalitetin", ka thënë ai për

"The Times". Alex ka pohuar se do të presë derisa personi i duhur të vijë dhe se ai nuk do të nxitojë për martesë. "Unë nuk do të ngutem, unë jam më romantik se kaq. Kam miq që janë nxituar dhe ata nuk janë të lumtur dhe pastaj kalojnë në divorce", ka thënë ai.



## Nick Jonas dhe Priyanka Chopra do të martohen në një pallat indian

**V**etëm edhe pak javë kanë mbetur dhe Nick Jonas dhe Priyanka Chopra do të jenë 'burrë dhe grua'. Së fundmi, britanikja "The Sun" ka zbuluar hollësi lidhur me planet për dasmën e çiftit që duket se do të jetë e mrekullueshme. Ylli 26-vjeçar i

muzikës dhe aktorja 36-vjeçare kanë në plan të shijojnë një javë festime në vendin e saj të origjinës (Indi) para dasmës. "Do të jenë disa ngjarje para dasmës, përfshirë një ceremoni kristiane, të gjitha në Indi", ka thënë një burim i afërt me çiftin për "The Sun".

## Kevin Hart dhe gruaja e tij pushojnë në Meksikë



**K**evin Hart dhe bashkëshortja e tij Eniko po kalojnë ditë të mira në Meksikë. Çifti janë parë në një pishinë të dielën në mbrëmje, në Punta Mita,

Meksikë. Kevin shfaqti trupin e tij të formësuar, ndërkaq Eniko dukej seksi në bikini të zeza. Çifti e dokumentoi tripin e tyre në "Instagram".

## Liam dhe Luke Hemsworth ndihmojnë njerëzit pas zjarreve në Kaliforni



Liam Hemsworth dhe Luke Hemsworth janë fotografuar me maska në fytyrë derisa po silleshin rreth lagjes së tyre në Malibu për të ndihmuar në rimëkëmbjen

nga zjarret në Malibu të Kalifornisë. Djemtë ndihmuan mes zjarreve të tmerrshme që po zhvillohen aktualisht në Kaliforni. E dashura e Liam, Miley Cyrus, thotë se shtëpia e tyre është djegur e tëra.



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

SWITZERLAND - QATAR

4+

CRUZEIRO - CORINTHIANS

3+

PALMEIRAS - FLUMINENSE

1

## Zogaj: Titullin e Gjermanisë, pastaj të botës

Altin Zogaj është një nga sportistët shqiptar që po e prezanton në mënyrën më të mirë Kosovën. 25-vjeçari që jeton dhe vepron në Shtuttgart të Gjermanisë ka zhvilluar tri meçe në boks profesionist dhe në të tria ka dalë fitimtar. Zogaj për "Epokën e re" ka treguar se synimi i tij është fillimisht titulli i kampionit në Gjermani, më pas titulli i kampionit të botës në boks



boksierit të famshëm shqiptar, Luan Krasniqi. Lidhur me punën me këtë trajner, Zogaj ka deklaruar: "Fazën e tretë të përgatitjeve për meçin e fundit e kam bërë në Berlin, përkatësisht te 'Agon Sports' me ish-trajnerin e Luan Krasniqit, Torsten Schmitz. Më ka përgatitur shumë mirë dhe nuk e përjashtoj mundësinë që në të ardhmen të punoj me të". Altin Zogaj ka bërë edhe një krahasim në mes të boksit amator dhe atij profesional.

"Jam i kënaqur që kam kaluar në boks profesionist, pasi gjithçka është duke më shkuar mirë, por këtu është shumë më vështirë sesa në boks amator. Atje kanë qenë vetëm tri raunde dhe dorëzat ishin më të trasha dhe nuk ke ndër shumë dhimbje, kurse tash ka më shumë raunde dhe thjesht çdo meç është përballje burrash", ka shtuar ai.

Duke folur për ambicjet në të ardhmen, bokseri Zogaj është tepër i matur dhe si synim para vetes ka garimin për titullin e kampionit në Gjermani, kurse objektivi kryesor mbetet titulli i botës. "Ekziston mundësia që në dhjetor të bëj ndonjë meç, kurse vitin tjetër të tentoj të luftoj për ndonjë

titull kampioni të Gjermanisë. Në të ardhmen synimi im i madh është të bëhem kampion i botës, të arrij këtë sukses që ende nuk e ka arritur asnjë shqiptar. Megjithatë, për këtë sukses duhen vite, por edhe shumë punë", ka deklaruar Zogaj.

### Futbollisti i rikthyer në boksier të pamposhtur

Një fakt interesant është se Altin Zogaj ka qenë një futbollist i talentuar, por më pas e braktisi futbollin për ta vazhduar karrierën në boks. "Historia ime është interesante. Sa isha fëmijë kam filluar të luaj futboll. Gjithçka shkonte si më së miri, por më është dashur të largohem nga ky sport për shkak të shkollës. Më pas shtova disa kilogramë dhe në vitin 2015 vëllai, Miloti, më propozoi të ushtroj boks vetëm për të hequr disa kilogramë. Në këtë mënyrë sporti i boksit më hyri në zemër dhe nuk do ta braktis asnjëherë. Në mesin e vitit 2015 e deri në 2018-n kam garuar në boks amator, kurse tash jam boksier profesionist. Më pëlqejnë sportet individuale, pasi gjithçka varet nga

vetvetja, derisa në futboll për të arritur deri te sukcesi nuk mjafton që vetëm një të jetë i mirë, se ajo është lojë kolektive", ka shtuar Zogaj.

### "Marshi i UÇK"-së e bën të pathyeshëm Altinin

Boksieri shqiptar Altin Zogaj, krahas suksesit në sportin e boksit, nuk e harron asnjëherë vendin e lindjes, Kosovën. Madje ai ndihet edhe patriot, që dëshmon fakti se gjithmonë në ring hyn me tingujt e këngës "Marshi i UÇK"-së. "Ndihej dhe jam patriot. Këtë e kam trashëguar nga familjarët të cilët kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjithmonë kam qenë i lidhur shpirtërisht me Ushtrinë Çlirimtare dhe me Kosovën, prandaj të gjitha veprat e mia të suksesit janë për Kosovën. Kënga 'Marshi i UÇK'-së më jep adrenalinë para çdo meçi dhe disi më bën të pathyeshëm përballë kundërshtarëve, ashtu sikurse i bënte edhe ushtarët e lirisë në luftimet përballë armikut", ka deklaruar Zogaj, i cili në fund premtan se gjithmonë do të boksojë për shtetin e Kosovës.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Boksieri shqiptar nga Komorani i Drenasit, Altin Zogaj, është duke garuar fuqishëm në boks profesionist, pasi këtë muaj e regjistroi edhe fitoren e tretë me radhë ndaj boksierit hungarez Istvan Zeller, në kategorinë gjysmë të rëndë, deri në 79.3 kg. Altin Zogaj të martën për "Epokën e re" ka treguar në detaje luftën e fituar më 3 nëntor në Wangen të Gjermanisë. "Nuk ka qenë aspak e lehtë, pasi kundërshtari ka qenë i papërshtatshëm. Ai e kishte syrin e mirë, sepse dinte të mbante distancën për faktin se ka 38 fitore në profesionalizëm, kurse unë nuk kam aq ndeshje të zhvilluara në karrierën time. Ai është një



## "Dardanët" vazhdojnë përgatitjet për Maltën dhe Azerbajxhanin

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka zhvilluar edhe stërvitjen e dytë për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Futbollistët "Dardanët", të udhëhequr nga trajneri Bernard Challandes, të martën në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë janë për-

gatitur për sfidat e 17 nëntorit ndaj Maltës dhe më 20 nëntor ndaj Azerbajxhanit. Optimizmi për këto dy ndeshje është i madh, kurse sulmuesi Vedat Muriqi ka paralajmëruar se Kosova e siguron kualifikimin në Maltë dhe e feston tri ditë më vonë në Prishtinë. "Presim

të kualifikohemi tutje dhe jemi shumë optimistë për këtë. Besoj se do të arrijmë të përgatitemi mirë dhe ta arrijmë kualifikimin qysh në Maltë, pastaj të kthehemi në shtëpi kundër Azerbajxhanit për festë", ka thënë Muriqi. Optimist për suksesin historik

është edhe sulmuesi Donis Avdijaj. "Është hera e parë për ne si ekip që të arrijmë diçka. E kemi mundësinë dhe kualitetin që t'i fitojmë të dy ndeshjet, por secili ekip tash di të luajë futboll dhe i ka opsionet e veta, prandaj duhet ta japim maksimumin si ekip



për t'i fituar ndeshjet, pastaj për ta festuar suksesin e parë", ka thënë Avdijaj.



## Gjimshiti paralajmëron fitore ndaj Skocisë

TIRANË, 13 NËNTOR - Mbrojtësi i Atalantës, Berat Gjimshiti, është optimist se Shqipëria mund të arrijë tri pikë në ndeshjen ndaj Skocisë, të shtunën në kuadër të Ligës së Kombeve. "Besoj se me

Skocinë do të jetë një ndeshje e vështirë. Ata luajtën me mirë atje. Ne kemi rastin t'i tregojmë vlerat tona. Në fund do të arrijmë atë që duam. Nëse luajmë si skuadër, e dimë se jemi të fortë. Tifozët?

Mendoj se na kanë përkrahur gjatë gjithë kohës. Shpresoj se do të jenë në stadium, të na japin forcën e tifozit", ka thënë Gjimshiti, i cili ka folur edhe për ndeshjen ndaj Izraelit. "Mbrojtja bëhet me

gjithë ekipin, nuk mbrohet vetëm me mbrojtësit. Ato që bëmë ishin gabime personale. Ndaj Izraelit kemi bërë gabime më shumë personale. Na kushtuan", ka shtuar Gjimshiti.



## KON-i qorton Spanjën, shkak padrejtësitë ndaj Kosovës

PRISHTINË, 13 NËNTOR - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) iu ka bërë thirrje federatave ndërkombëtare që të mos organizojnë ngjarje sportive në Spanjë, përveç nëse vendi mund të garantojë pjesëmarrje të barabartë për të gjithë konkurrentët, duke përfshirë atletët nga Kosova. Paralajmërimi vjen pas polemikave lidhur me faktin se qeveria spanjolle i ndaloi pjesëmarrësit nga Kosova që të konkurrojnë me flamurin e tyre në Kampionatin Botëror të Karatesë 2018 në Madrid. "Nëse qeveria spanjolle nuk i ka kushtet për të garantuar aksesin jo vetëm në Kosovë, por për çdo atlet për të konkurruar, ne duhet t'i paralajmërojmë të gjitha federatat ndërkombëtare që, derisa kjo të zgjidhet, ata nuk duhet të mbajnë gara ndërkombëtare atje", ka thënë drejtori i IOC-së për marrëdhëniet e Komitetit Olimpik



Kombëtar (NOC), Pere Miro. Kosova, e cila shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, është njohur nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) në 2014, duke marrë të drejtën për të marrë pjesë në ngjarjet sportive ndërkombëtare si një shtet i

pavarur, shkruan "Reuters". Atletët kosovarë u lejuan të marrin pjesë në Kampionatin Botëror të Karatesë, por u detyruan ta mbanin uniformën 'neutrale' pa emblema kombëtare. Flamuri i Kosovës ishte gjithashtu i ndaluar në konkurrim.

## Golden State ndëshkohet në shtesë, triumfojnë Oklahoma dhe Dallasi

OHIO, 13 NËNTOR - Koha shtesë ka ndëshkuar Golden State, që u mund 121-116 nga Clippers, ndeshje ku vendësit patën një epërsi të lehtë gjatë gjithë kohës, por në fund shifrat u barazuan 106-106. Për Clippersat, gjashtë lojtarë realizuan mbi 10 pikë, me Lou Williamsin që realizoi 25 pikë e Harrelli 23, të dy lojtarë që e nisën ndeshjen nga stoli, raporton "Telesport". Për Warriorsin u dallua Duranti, me një "triple double" (33 pikë, 11 rebaunde e 10 asistime, mbështetur edhe nga Thompsoni me 31 pikë, por që mbetën për statistikë (vijon të mungojë Curry, i dëmtuar). Humbet skuadra e San Antonios, që u mund 104-99 nga Sacramento, sfidë në përgjithësi e ekuilibruar, por vendësit u shkëputën në fund dhe triumfuan falë 22 pikëve të Bogdanoviqit. Dallasi mposhti 103-99 Chicagon, ndeshje e luajtur në fushën e këtij të fundit. LaVine me 26 pikë ishte shënuesi më i mirë i takimit, por që s'mjaftuan për ta evituar



humbjen e Bullsave, ndërsa për teksantë u dallua Barnes me 23 pikë. Fitorja e nëntë sezonale për Philadelphian, që mposhti 124-114 Miamin, takim i komanduar nga miqtë, të karikuar edhe nga lajmi i transferimit të Butlerit (nuk luajti). Më i mirë në fushë ishte Embiid me 35 pikë e 18 rebaunde, që pati edhe ndihmën e Reddickut me 25 pikë. Rikthehet te fitorja skuadra e Oklahomës, që mundi 118-101 Phoenixin (George 32 pikë), ndërsa Minnesota mundi

120-113 Brooklyn, falë 25 pikëve e 21 rebaundeve të Townsit.

### REZULTATET

Washington - Orlando	117-109
Miami - Philadelphia	114-124
Toronto - New Orleans	110-126
Chicago - Dallas	98-103
Memphis - Utah Jazz	88-96
Minnesota - Brooklyn	120-113
Oklahoma - Phoenix	118-101
Sacramento - San Antonio	104-99
Clippers - Golden State	121-116

### SHKURT

#### Corinna Schumacheri: Schumi nuk po dorëzohet

Michael Schumacher kishte pësuar lëndim gjatë skijimit në vitin 2013, duke pësuar lëndime në tru, e që gjendja e tij vazhdon të jetë e rëndë. Legjenda e Formula 1 ka pësuar lëndime në tru, ku ka bërë që ai të qëndrojë në koma për kohën më të gjatë. Gruaja e Michael Schumacherit, Corinna, ka thënë se ai nuk po dorëzohet, edhe pse janë kohë të vështira për familjen. "Ndhim mirë kur marr kaq shumë urime dhe fjalë të mira që mbështesin familjen tonë. Ne të gjithë e dimë se Michael është një luftëtar dhe nuk do të dorëzohet", ka thënë 49-vjeçarja. "Do të doja të të falënderoja sinqerisht për mesazhin dhe dhuratën e këndshme që do të na ndihmojë ta kalojmë këtë kohë të vështirë", ka shtuar më tej Corinna.

Kujtojmë se Michael Schumacheri gjatë karrierës së tij në Formula 1 ka arritur të fitojë shtatë tituj të kampionit të botës dhe numrin më të madh të garave të fituar, gjithsejtë 91.

#### Mbappe: E pahijshme të ketë kaq para në futboll

Kylian Mbappe është një nga yjet e futbollit botëror pavarësisht prej moshës së re. Sulmuesi i PSG-së nuk i ka mbushur ende 20 vjeç, ndërsa ka fituar Kupën e Botës me Francën dhe është shpallur lojtari i ri më i mirë i turneut. Në verën e kaluar ai la Monacon për t'u transferuar në kryeqytetin francez për shumën e 180 milionë eurove. Lojtari firmosi një kontratë pesëvjeçare, nga e cila përfiton 290 mijë sterlina në javë. Çmimet e kartonëve të lojtarëve dhe rrogat e tyre kanë shkuar në qiellin e shtatë dhe Mbappe e cilëson si "të pahijshme" një gjë të tillë. Ky është sistemi dhe ai tregon se nuk ka çfarë të bëjë, përveçse të përshtatet dhe të tregojë respekt. "Është vërtetë e pahijshme për mua, që vij nga një familje modeste dhe e ndershme, por tregu është i tillë. Bota e futbollit punon në këtë mënyrë. Unë nuk do ta revolucionoj futbollin, jam pjesë e sistemit. Të duhet të dish se si ta respektosh dhe të qëndrosh pjesë e saj", ka thënë Mbappe.

#### Mourinho rezikon shkarkimin

Jose Mourinho do të shkarkohet nga posti i trajnerit të Manchester Unitedit nëse dështon ta sigurojë një vend në top katër të sezonit të Premierligës, raporton "Sun". Skuadra e trajnerit portugez renditet e teta me 20 pikë momentalisht, shtatë më pak se vendi i katërt, Tottenhami. Ndërkohë, pikërisht trajneri i Tottenhamit, Mauricio Pochettino, përmendet si zëvendësues i mundshëm i Mourinhos. Në 12 xhirot e para të këtij sezoni Unitedi i ka fituar gjashtë, i ka humbur katër dhe ka barazuar në dy raste, dhe ka një gol dallim negativ, pasi i ka shënuar vetëm 20 gola, ndërsa i ka pranuar 21 sosh.

#### Di Carlo zëvendëson Venturan

Gian Piero Ventura qëndroi vetëm katër ndeshje në krye të Chievos, ku regjistroi tri humbje dhe një barazim. Pikërisht pas pikës së parë të marrë në barazimin 2-2 kundër Bolonjës, ish-trajneri i Italisë dha dorëheqje nga veronezët e vegjël. Chievo gjendet në një nga situatat më të vështira në vitet e fundit, pasi ndodhet në vendin e fundit me zero pikë. Ekipi numëron tri barazime dhe nëntë humbje, ndërsa e nisi kampionatin me -3 pikë. Drejtuesit e klubit nuk kanë vonuar dhe kanë zgjedhur trajnerin e ri. Ai është Domenico Di Carlo, i cili ka gjetur akordin për t'u liruar nga klubi i Novarës. Presidenti Kampedeli i ka ofruar një kontratë gjashtëmujore, me një premi ekonomike, nëse ia del ta shpëtojë ekipin. Di Carlo është gati për ta nisur sfidën me qëllimin për ta shpëtuar Chievon, ndërsa ai e njeh mirë ambientin, sepse ka punuar gjatë viteve 2008-2010 dhe një periudhë në sezonin 2011-2012 në stolin e ekipit veronez.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agjencia za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency

Sektori i Burimeve Njerëzore  
Sektor ljudskih resursa  
Human Resources Sector

Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Nr.14/2011 Për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe UA (MPMS) nr.05/2014 për ndryshimin dhe plotësimin e UA 14/2011 shpall:

### KONKURS

Titulli i pozitës: Roje e Pylli, Gjahu dhe Peshkimi  
Ref: APK-01/18-LP  
Njësia organizative: DKR-Mitrovicë-VGJRV Dubočak  
Vendi i punës: VGJRV-Duboçak (1)  
Nëpunësi Mbikëqyrës: Zyrtari/e i/e lartë në Vendgjutëin me Rëndësi të Veçantë: Dubočak  
Grada e pagës (Koefficienti): pese(5) -302.70 bruto  
Lloji i pozitës së punës: Me kohë të pa caktuar,  
Kohëzgjatja e periudhës provuese: gjashtë(6) muaj

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Angazhimi i drejtpërdrejtë në mbrojtje të pyllit, gjuetisë dhe peshkimit si dhe resurseve Natyrore;
2. Bashkëpunimi me teknikun-kontrollorin, për mbrojtje të mirëfilltë të pyjeve si dhe me rojën e pyllit me të cilin kufizohet;
3. Parashtrimi i fletëparaqitjeve për vjedhje pylli, gjahu dhe peshkimi, dhënia e deklaratës teknikut për përpunim të mëtejshëm;
4. Përfaqësimi i lëndëve-fletëparaqitjeve për vjedhje pylli, gjahu dhe peshkimi në gjykata në cilësi të dëshmitarit;
5. Evidentimi i të dhënave në ditarin e punës dhe librin e cungjeve;
6. Pjesëmarrja në pranim të asortimenteve drusore dhe produkteve jodrunore në fazën e kultivimit, shfrytëzimit, pyllëzimit dhe damkosjes;
7. Angazhimi në punët silvikulturale të pyllit (pastrime, rrallime, ndriçime, pyllëzime etj.), shpërndarjen e ushqimit plotësues (misër, bari, kripë guri etj) për kafshë të egra, kositjen e livadheve dhe sistemimin e barit në pleme ose stog, riparimin e rrethojës së jashtme dhe të brendshme, riparimin e vëzhgimoreve, koritave të ushqimit, vend kriporeve, kurtheve, rrugëve, digave të liqeneve, gypave të ujit etj, përcjelljen e gjendjes së kafshëve në çdo aspekt, numërimin dhe reproduktimin e tyre,
8. Mbrojtja obligative e të gjitha shenjave në pyll (parcelave-reparteve, nënparcelave, sipërfaqeve (provë) etj. Si dhe riparimi-vënia e sërishme e shenjave që mungojnë;
9. Realizimi dhe kryerja e punëve të tjera sipas urdhërit të Menaxherit të drejtpërdrejtë dhe atij kryesor.

Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja :

- Përvoja e punës në pylltari është prioritet.
- Aftësi për vlerësimin e situatave dhe nevojave për marrjen e masave.
- Fleksibilitet dhe aftësi për të përballur me situata të reja.
- Njohja e përdorimit të mjeteve komunikuese, radiolidhje, telefona etj.
- Gatishmëria për përballje me rreziqe që mund të shfaqen.
- Aftësi për punë, bashkëpunim dhe informim me kohë.
- Aftësia për punë nën presion.
- Zotësia për mbajtje korrekte të evidencave dhe raportim.
- Të mos jetë i gjykuar për veprë penale me vendim të formës së prerë si dhe të mos ketë të iniciuar aktakuzë të pletfuqishme hetimore penale,

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për këtë pozitë:

Shkolla e mesme e Pylltarisë, Bujqësisë, Biologjisë dhe shkollim tjetër i mesëm relevant

Procedura e Konkurrimit:

Është e hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar.

Data e shpalljes së konkursit: 14.11.2018

Data e mbylljes së konkursit: 26.11.2018

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Vetëm kandidatët që hyjnë në listën e përzgjedhur do të informohen.

Dokumentet duhet të jenë fotokopje përndryshe nuk kthehen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Burimeve Njerëzore ,zra nr.2 në Agjencinë Pyjore të Kosovës, Rr. Zenel Salihu 1/A Prishtinë (prapa Muzeut të Kosovës).

Për informacione tjera shtesë kontaktoni në telefonin nr. 038-200-38-482 çdo ditë pune prej orës 8.00 deri 16.00.



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA -VLADA-GOVERNMENT

MINISTRIA BUIJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA  
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

Agjencia Pyjore e Kosovës  
Agjencia za Šume Kosova  
Kosovo Forest Agency  
Sektor ljudskih resursa  
Human Resources Sector

Na osnovu člana 8 Zakona o Radu Br.03/L-212 i Upravne Uredbe Br. 14/2011 Za regulisanje postupka o osnivanju radnog odnosa i Javnom sektoru i UU (MRSZ) br. 05/2014 za izmenu i dopunu UU 14/2011, objavljuje:

### KONKURS

Naziv pozicije: Čuvar šume, Lova i Ribolova  
Ref: AŠK-01/18-LP  
Organizaciona jedinica: AŠK- Priština, DMPDŽL i ET - Dubočak  
Radno mesto: MLPZ-Duboçak (1)  
Nadzorni službenik: Visoki službenik u Mesto Lovišta Posebnog Značaja: -Dubočak  
Grada plate (Koefficient): 5 pet,- 302.70 bruto  
Vrsta radne pozicije: Neograničeno vreme,  
Probni periodični period: Šest (6) meseci

Zadaci i odgovornost:

1. Direktno angazhovanje u zaštiti šume, lova i ribolova kao i prirodnih resursa;
2. Saradnja sa tehničarem – kontrolorom, za stvarno zaštitu šuma kao i sa čuvarom šuma, kojim se ograničava;
3. Podnošenje prijave za krađu šume, lova i ribolova, davanje izjave tehničaru za dalju obradu;
4. Zastupanje predmeta- prijave za krađu šume, lova i ribolova u sudovima, u svojstvu svedoka;
5. Evidentiranje podataka u dnevniku rada i knjigu panjeva;
6. Učestvovanje na prijem drvnih asortimenata i nedravnih proizvoda u fazi obrađivanja, korišćenja, pošumljenja i žigosanja;
